

ZGJËNDRRA E LUMTURISË SË MARTESËS SË HERSHME: RASTE STUDIMORE PËR MARTESËN NË MOSHË TË MITUR NË KORÇË DHE VLORË



KY STUDIM, PUNA KËRKIMORE DHE
VEPRIMTARITË, JANË MBËSHTETUR NGA
FONDI KANADEZ PËR NISMAT VENDORE

TIRANË, JANAR 2016

**ZGJËNDRRA E LUMTURISË
SË MARTESËS SË HERSHME:
RASTE STUDIMORE
PËR MARTESËN NË MOSHË
TË MITUR NË KORÇË DHE VLORË**

KY STUDIM, PUNA KËRKIMORE DHE VEPRIMTARITË, JANË MBËSHTETUR
NGA FONDI KANADEZ PËR NISMAT VENDORE

TIRANË, JANAR 2016



Activity supported by the
Canada Fund for Local Initiatives
Activité réalisée avec l'appui du
Fonds canadien d'initiatives locales



Ky studim është realizuar nga “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve” dhe u mbështet nga “Fondi Kanadez për Nismat Vendore”

Konsulent: Bernard Zeneli

Grupi i Punës së Rasteve Studimore:

Elma Tërshana	Drejtoresh Ekzekutive, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
Eridjona Kica	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
Mariana Jorgji	Shërbimi Social Shtetëror Korçë
Jonida Rustemaj	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve Vlorë

Në bashkëpunim me:

Në Bashkinë Korçë	
Pandi Papando	Drejtor i Spitalit Rajonal Korçë
Admir Belishita	Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë
Voltisa Bala	Përgjegjëse e Gjendjes Civile, Bashkia Korçë
Edmond Hysenbelli	Drejtor i Drejtorisë së Shëndetit Publik Korçë

Në Bashkinë Vlorë	
Alketa Gjybegu	Përgjegjëse e sektorit të Monitorim Vlerësimit dhe Planifikimit Familjar pranë DSHP Vlorë
Nereida Leka	Përgjegjëse e zyrës së Gjendjes Civile Vlorë
Enkela Dera	Specialiste Anti Trafiku Drejtoria e Policisë Vlorë

E Drejta e Autorit:

© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky material duhet të dërgohen në:

“Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”:
Bulevardi “Bajram Curri”, Pallatet “Agimi”, Shk 5, Ap. 81
Tiranë– Shqipëri
Tel/Fax: 00355 4 258 987
Webmail: www.observator.org.al

ISBN:

Përbajtja e këtij studimi është përgjegjësi e “Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve” dhe jo domosdoshmërisht paraqet opinionin e Fondit Kanadez për Nismat Vendore.

I. Tabela e Lëndës

I. Tabela e Lëndës	6
II. Lista e Shkurtimeve	9
I. Përmbledhje Ekzekutive	11
II. Fillesa për Studimin	17
A. Shtegu më pak i rrahur . . .	17
B. Fasada e dritëshkurtësisë në politikat për martesën dhe familjen	23
C. Pse kjo nismë dhe rastet studimore?	25
D. Pse u përfshi “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”?	30
E. Arsyetimi i përzgjedhjes së Korçës dhe Vlorës	31
III. Metodologjia, Burimet dhe Hendeqet Kërkimore	33
A. Metodologjia kërkimore	33
B. Problematika e Martesave në Moshë të Hershme dhe Fëminore	36
C. Kërkimi Shkencor dhe Burimet	44
D. Identifikimi i Njëanshmërisë Kërkimore	49
IV. Zhvillimi human kundrejt të drejtave të njeriut	52
A. Normat dhe legjislacioni për të drejtat e njeriut që trajton martesat e hershme dhe fëminore në Republikën e Shqipërisë	53

B. Përfaqësues të qeverisë, shoqërisë civile si dhe fëmijë raportojnë në Sesionin e 61 të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (17 Shtator– 5 Tetor 2012)	55
C. Vëzhgimet dhe rekomandimet përfundimtare të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve	56
D. Vazhdimi i procesit pas vëzhgimeve dhe rekomandimeve të Komitetit	57
V. Analiza e Thelbësoreve	61
A. Karakteristika demografike të Martesave të hershme në Korçë dhe Vlorë	61
B. Karakteristika të prejardhjes familjare të grave të martuara në moshë të hershme	65
C. Karakteristika arsimore të grave të martuara në moshë të hershme	68
D. Jeta familjare e grave të martuara në moshë të hershme	72
E. Statusi socio-ekonomik i grave të martuara në moshë të hershme	76
F. Arsyetimet për martesat e hershme	79
VI. Çështje Parësore të Grave të Martuara Herët	81
A. Lumturia familjare kundrejt asaj personale	81
B. Shkollimi si ëndërr e ndërprerë	85
C. Një punë brenda apo jashtë mureve të shtëpisë	86
D. Roli i qeverisjes vendore dhe komunitetit mbarë	86
E. Çfarë rezervon e ardhmja?	87
VII. Veprime dhe veprues	88
A. Kur strategjitë dështojnë- problemet lulëzojnë	88
B. Rrathë palësh të interesuara dhe qëndrimet e tyre ndaj martesës së hershme	89
C. Ndërhyrjet e Komuniteti Ndërkombëtar dhe Kombeve të Bashkuara	90

D. Qeverisja vendore, policia, spitalet dhe gjykatat rajonale	91
E. Shoqëria civile dhe organizatat e grave	91
F. Mediat dhe seksualiteti i adoleshentëve	92
G. Martesat e hershme të lidhura me migrimin	93
VIII. Propozime për veprime politikëbërëse	94
A. Propozime për politika që mund të merren përsipër nga “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”	94
B. Ndërhyrje të aktorëve kyç në çështjen e martesave të hershme si shkelje e të Drejtave të Njeriut	94
C. Ndërhyrje të aktorëve kyç në trajtimin mbarëkombëtar të martesave të hershme	95
IX. Përfundime	97
A. Gratë në martesa të hershme si sasi dhe cilësi	97
B. Si të aftësojmë profesionalisht gratë e martuara në moshë të hershme?	98
C. Aktorët Ndërkombëtarë, Kombëtarë dhe Vendorë	98
D. Epilog përmbyllës	100
X. Shtojca	102
A. Pyetësi i përdorur për të anketuarit e martesave të hershme në Korçë dhe Vlorë	102
Pyetësor	102
XI. Bibliografia	109

II. Lista e Shkurtimeve

CEDAW:	Konventa për Eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas
CFLI:	Fondi Kanadez për Nismat Lokale
OSHC:	Organizatat e Shoqërisë Civile
KDF:	Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve
BE:	Bashkimi European
FDI:	Investimet e huaja direkte
QSH:	Qeveria e Shqipërisë
INSTAT:	Instituti i Statistikave në Shqipëri
ON:	Organizata Ndërkombëtare
IOM:	Organizata Ndërkombëtare për Migrimin
IPA:	Instrument of Pre-Accession Assistance
IT:	Teknologji Informatike
NJQV:	Njësia e Qeverisjes Vendore
LLL:	Të mësuarit gjatë gjithë jetës
MMSR:	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
OJF:	Organizata Jo-Fitimprurëse
Observatori:	“Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”
OKB:	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP:	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
UNFPA:	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNICEF:	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UN-Women:	Organizata e Kombeve të Bashkuara për barazi gjinore dhe fuqizim të gruas

I. Përmbledhje Ekzekutive

Kjo ndërmarrje analizon martesat e hershme dhe në moshë fëmimore në Shqipëri me këndvështrim nga terreni. Ai fokusohet në qytetet e Korçës dhe Vlorës dhe situatën e atjeshme me dukurinë e martesës në moshë të mitur. Studimi është kryer në kuadrin e projektit “Parandalimi i martesave të hershme në Shqipëri” (faza e II-të) zbatuar nga “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”, dhe është mbështetur nga Fondi Kanadez për Nisma Vendore. Ai bazohet në rezultatet dhe përvojën e fituar gjatë fazës së parë të zbatimit të projektit i cili u ndërmor për të vlerësuar dukurinë e martesës së hershme me këndvështrim specifik mbi komunitetin Rom në Shqipëri.

Ajo që paraqitet në faqet në vijim është një përshkrim analitik rreth grave që kanë përjetuar martesën e hershme, të cilat aktualisht jetojnë në Korçë dhe Vlorë. Në secilin qytet u zhvillua rasti studimor që u pasurua me të dhëna statistikore të rezultuara prej intervistave fokusuar te një kampionim i grave të martuara herët dhe nga diskutime në grup të cilat përfshinë edhe përfaqësues të qeverisë vendore dhe shoqërisë civile së bashku me gra që e kishin kaluar përvojën e martesës në moshë të hershme. Falë bashkëpunimit të shkëlqyer me njësitë e qeverisjes vendore, policinë, spitalet, dhe gjykatat është mundur

mbledhja e të dhënave sasiore dhe cilësore të plota dhe reale me një koeficient të ulët gabimi, të krahasueshme me ato të vendeve në të cilat evidentohen dukuri të ngjashme. Studimi synon të rrisë ndërgjegjësimin publik në lidhje me çështjen e martesave të hershme jo vetëm si një dukuri e një grupi etnik në minoritet, por si një dukuri në rritje e cila duhet të frenohet me të gjitha mënyrat deri në eliminimin e plotë të tij. Për këtë kërkohet urgjentisht vëmendja dhe angazhimi i gjithësecilit në rolet dhe përgjegjësitë përkatëse, duke përfshirë këtu ndryshimet e nevojshme legislative, si dhe hartimin e strategjive, politikave mbështetëse për integrimin efektiv të grave apo aktualisht të miturve të martuar në shoqërinë shqiptare.

Ky vlerësim ka për qëllim të ofrojë një aparat analitik që nga njëra anë siguron kuadër të detajuar të dukurisë të martesave të hershme në njësitë e zgjedhura të qeverisjes vendore (Korçë dhe Vlorë), ndërsa në anën tjetër, mundëson propozime konkrete mbi politikën ndërhyrëse të nevojshme si në nivel qendror ashtu dhe në atë vendor ku të gjithë aktorët, përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe mediat, marrin përgjegjësitë përkatëse dhe koordinojnë punën mes tyre për t'iu qasur efektivisht dukurisë në të gjitha përmasat e saj. Ndryshe nga studimet e tjera që merren me këtë çështje, ne jemi përpjekur të paraqesim një këndvështrim që është më pranë grave që martohen herët duke mbajtur në konsideratë nevojat e tyre dhe duke mbrojtur identitetin dhe të drejtën e privatësisë. Rastet studimore tentojnë të ofrojnë një themel bindës për studimin e dukurisë në mbarë vendin së bashku me rekomandime konkrete për të eliminuar këtë dukuri. Ne besojmë se përmes një fushate kombëtare që i dedikohet kësaj çështje, gratë e martuara

herët do t'i bëheshin zëdhënëset më të mira për të rritur dhe ndjeshmërinë e për të ndërgjegjësuar për këtë dukuri.

Ky vlerësim identifikon dy lloje situatash të martesave të hershme që përkojnë me fazat e tranzicionit social-politik në Shqipëri. Në Korçë, grupmosha është më e pjekur dhe grate kryesisht janë martuar gjatë dekadës së fundit të shekullit të 20-të, ndërsa në Vlorë martesat e hershme kanë ndodhur gjatë dekadës së parë të këtij shekulli. Kështu, martesa e hershme renditet ndër ato 'nënprodukte' të tranzicionit që u vetëtheksua në një kohë kur normat dhe vlerat shoqërore u vunë në pikëpyetje apo thjesht nuk ishin më.

Botëkuptimi i shqiptarëve në përgjithësi duket se është përmirësuar ndjeshëm gjatë 20 viteve të fundit, por fatkeqësisht ende ekzistojnë skuta ku prapambetja nga moszhvillimi është përkeqësuar nga tranzicioni i tejzgjatur. Rastet studimore hedhin dritë mbi këtë çështje dhe martesa në moshë të hershme është pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së zhvillimit shoqëror dhe njëkohësisht një përgjigje e nevojës themelore për të mbijetuar. Ato (rastet studimore) tregojnë se kultura e martesës në Shqipëri ka ndryshuar, por ky përfundim duhet të vërtetohet më tej në nivel kombëtar duke zbërthyer të dhënat që lidhen me arsimin dhe martesën.

Rastet studimore të ndërmarra nuk viktimizojnë apo shfrytëzojnë gratë e martuara në moshë të hershme. Përkundrazi, ne kundrojmë përvojat e tyre jetësore dhe përpiqemi të analizojmë efektet e procesit të martesës së hershme tek to dhe mbi shoqërinë ku ato jetojnë. Ne, gjithashtu, jemi ndalur në kuadrin ligjor i cili ka favorizuar martesat e hershme, duke ofruar rekomandime mbi

rishikimin e disa ligjeve dhe politikave të cilat mund të gjejnë zbatim të menjëhershëm dhe të ndikojnë pozitivisht në reduktimin/ eliminimin e dukurisë. Diskutimi i martesës së hershme dhe ndërthurja me dukuri të tjera si ai i seksualitetit tek adoleshentët, trafikimi dhe migrimi është i pashmangshëm, duke patur parasysh se këto janë dukuri që shoqërojnë tranzicionin dhe vazhdojnë të ekzistojnë edhe në fazat e zhvillimit të mëtejshëm.

Gratë e intervistuar dhe të marra në konsideratë në këto raste studimore evidentojnë se martesë e hershme pengon përparimin shkollor dhe profesional. Shumica e tyre kanë një nivel të ulët arsimor dhe nuk planifikojnë të kthehen në shkollë pas lindjes së fëmijës. Për më tepër, ato nuk e shohin veten e tyre duke zhvilluar një jetë profesionale jashtë familjes. Mungesa e arsimit dhe e mundësive ka një ndikim mjaft negativ tek gratë që duan të riintegrohen dhe pasojat e kësaj situatë kanë ndikim të gjerë për të gjithë shoqërinë.

Kjo analizë e përkufizon gjendjen e tanishme të dukurisë së martesës së hershme si një realitet të dyzuar që ekziston në letër (de jure) - Shqipëria ka një kuadër ligjor që ndalon ekzistencën e kësaj dukurie dhe në aktualitet (de facto) - projekti që Observatori ndërmorri për të kuptuar shtrirjen dhe intensitetin e kësaj dukurie. Rezultatet e studimit përputhen me trendin ndërkombëtar, faktin që numri i vajzave është krahasimisht shumë më i madh se ai i djemve dhe se ato u përkasin familjeve dhe komuniteteve ku mbizotërojnë qëndrime mjaft diskriminuese dhe paragjykitje të ashpra gjinore. Për fat të keq, evidentohet qartë se martesë e hershme shkel të drejtat e zhvillimit të vajzave (shëndetësore, arsimore,

si dhe rritje profesionale), të drejtat e tyre për të qenë të mbrojtura (rrezikun ndaj dhunës në familje dhe abuzimit) dhe të drejtat për pjesëmarrje.

Duke analizuar faktorët që kontribuojnë në martesat e hershme dhe pasojat e saj në një kontekst të karakterizuar nga forma apatike të marrëdhënieve me aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë, ne e konsiderojmë martesën e hershme si një çështje që po kthehet në një problem i cili duhet të adresohet nëpërmjet një zgjidhje shumëplanëshe që përfshin: bashkëpunimin e vendimarrësve dhe ligjvënësve në nivel qendror për të realizuar amendimet ligjore të Kodit të Familjes në mënyrë që të mos lejojë martesën nën moshën 14 vjeç, me vendim gjykatë; shoqërisë civile e cila të mbështesë, promovojë dhe punojë për ndërgjegjësimin e shoqërisë në nivel lokal dhe përfshirjen e grave/ vajzave në këto aktivitete, jehona e të cilave mund të shtrihet në shkallë kombëtare; angazhimin e qeverisë lokale e cila të ketë një sensitivitet kundrejt këtij target grupi, duke prioritetizuar dhe krijuar kushtet për plotësimin e nevojave të tyre. Shërbimet sociale në nivel lokal duhet të angazhojnë gratë/ vajzat e martuara në moshë të hershme në aktivitetet e tyre sensibilizuese dhe mbështetëse. Pjesët e fundit të këtij studimi propozojnë zgjidhje shumëplanëshe dhe shumësektoriale të cilat paraqiten në formën e rekomandimeve dhe aksioneve që duhet të ndërmerren në fazën pasardhëse e cila përshkallëzon adresimin e kësaj çështjeje në nivel kombëtar.

Ky studim u krye nga një grup ekspertësh, përfshirë aktorët kryesorë, përfaqësues nga qeveria vendore, gjykatat dhe policia në Korçë dhe Vlorë. Përvoja e fituar na forcon besimin se bashkëpunimi i shoqërisë civile dhe

donatorëve ndërkombëtare me qeverinë qendrore dhe vendore mund të jetë çelësi për të siguruar eliminimin e dukurisë të martesave të hershme. Kombinimi i aftësive multidisiplinore të ekipit studimor, si përvoja e punës me gratë, fëmijët dhe rininë, aftësitë komunikuese, intervistuese si dhe në hulumtime statistikore ndihmuan në identifikimin dhe dokumentimin e disa tipareve të dukurisë të cilat nuk ishin evidentuar më parë. Zhvillimi i një qasje ekipore për të kuptuar më mirë dhe adresuar më efektivisht dukurinë rezultoi të jetë një tjetër kontribut i këtij studimi, duke treguar se njohja e një dukurie sociale dhe rrugëzgjdhjeve me bazë komunitare dhe shfrytëzim të burimeve vendore rezultoi të jetë aspak i kushtueshëm dhe shumë efikas përse i përket ndërhyrjes në kohën e duhur. Bashkëpunimi efektiv ndërmjet strukturave shtetërore të mbështetura nga shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë duke aplikuar qasjen vendore mund të influencojë pozitivisht ndërhyrjet për parandalimin dhe eliminimin e dukurisë së martesave të hershme.

II. Fillesa për Studimin

A. Shtegu më pak i rrahur...

Trajtimi i çështjeve që lidhen me martesat në moshë të hershme si probleme shoqërore të grave dhe të rejave, në nivel vendor, mund të konsiderohet risi dhe progres në vende si Shqipëria ku tranzicioni drejt një qeverisje demokratike dhe më përfaqësuese është tejzgjatur. Rrugëtimi në shtegun e parrahur drejt ekonomisë së tregut dhe shoqërisë së hapur u shoqërua me sakrifica dhe kosto të larta sociale. Ekzistojnë shumë udhëkryqe në shoqërinë shqiptare të shekullit të 21. Për të ndjekur drejtimin e duhur kërkohet një vendimarrje e bazuar në avantazhet e provuara të një politike kundrejt një tjetre - një proces që në Shqipëri as nuk ka qenë dhe as nuk pritet të jetë i lehtë. I tillë është rasti me situatën e martesave të hershme. Të kuptuarit e dukurisë përtej të dhënave statistikore dhe gjetja e mënyrave dhe mjeteve për t'a adresuar atë si shoqëri kërkon guxim dhe vendosmëri politike për të ndërmarrë veprimet e duhura drejt përmirësimit të situatës.

Tranzicioni i shoqërisë shqiptare, në vitet '91– '92, nga një regjim diktatorial autoritar drejt demokracisë ka qenë dramatik përse i përket normave, kodeve dhe kulturës. Modelet e normave dhe sjelljes gjatë epokës

komuniste, ndërsa zëvendësoheshin gradualisht me normat dhe sjelljet e shoqërive të hapura dhe demokratike, në fakt realisht ngatërroheshin duke u zëvendësuar me zakone logjike të kombinuara me traditat imagjinare të para Luftës së Dytë Botërore miksuar dhe me normat e sjelljeve të mësuara gjatë emigrimit. Këto norma dhe sjellje gjithashtu kanë lejuar një shtrirje të korrupsionit në shkallë të gjerë, abuzim të pushtetit në marrëdhëniet familjare, trafikim të qenieve njerëzore, punës dhe prostitucionit të detyruar në njërin anë, dhe në tjetrën - përpjekje të vazhdueshme për të strukturuar një sistem socio-politik të bazuar në respektimin e të drejtave individuale të njeriut. Komplexiteti i dyfishtë i realitetit shqiptar (ai në letër dhe ai në aktualitet), një emërues i përbashkët i tranzicionit të tejzgjatur drejt ekonomisë së tregut dhe sistemit politik demokratik, shfaqet ngjashëm edhe në situatën e martesave në moshë të mitur. Në terma historikë dhe ligjorë qeveritë shqiptare kanë qenë të prirura për të hartuar ligje dhe rregullore për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të grave, duke përfshirë rregullimin e martesës në një moshë të përshtatshme.¹ Në fakt, ky studim tregon se martesat e hershme ekzistojnë si ligjërisht ashtu dhe ilegalisht duke evidentuar nevojën për përmirësim të politikave sociale.

Në Shqipërinë e sotme vihet re një mungesë e theksuar

¹ Kushtetuta e Monarkut Shqiptar, e vitit 1928, ndaloi mbulimin e fytyrës së gruas në publik; Regjimi komunist filloi një lëvizje të grave në vitin 1968 për emancipimin e grave dhe barazinë gjinore; në sistemin aktual Shqipëria ka miratuar disa ligje dhe traktate për të drejtat e grave, përfshirë CEDAW në vitin 1993 (Ligji 7769 / 9.11.1993). Megjithatë zbatimi i të gjitha këtyre ligjeve mbi të drejtat e grave ose është bërë formalisht në disa zona afër kryeqytetit ose është injoruar plotësisht duke thelluar më tej pabarazinë gjinore.

e kohezionit social krahas mungesës së rolit dominues të ish shtetit atëror. Brenda këtij konteksti të pafat, ndërsa ekonomikisht dhe financiarisht shqiptarët janë shumë më mirë në krahasim me çerekun e fundit të shekullit të 20-të, individit dhe shoqërisë i është dashur të përplasen me baticat dhe zbaticat që kanë tronditur dukshëm themelet e vlerave duke krijuar një sistem amorf pa një thelb të qëndrueshëm moral dhe filozofik.

Gjatë komunizmit, qeveria shqiptare u investua në forma ideologjike të ndryshme duke luftuar kundër asaj që konsiderohej si “martesa në djep”- e cila përfaqësonte një formë detyruese të martesës së një fëmije me një person të një familje të caktuar që prej çastit të lindjes. Dëshmitë e këtij tipi angazhimi bashkëshortor nuk janë më relevant për kontekstin aktual. Fëmijët dhe përfshirja e tyre në martesa të hershme ka marrë të tjera forma dhe trajta. Studimet e ndërmarra nga UNICEF dhe UNFPA në Shqipëri tregojnë se rreth 10% e femrave të martuara të moshës 20 deri 24 ishin martuar përpara se të arrinin moshën 18 vjeçare, pra moshën ligjore të martesës në Shqipëri. Sipas një raporti tjetër të UNFPA-së në Shqipëri (2011) rreth 31% e fëmijëve romë femra, ndërmjet moshës 13 vjeç dhe 17 vjeç ishin të martuara.

Shumë rëndom ndeshet edhe skicimi i një vajze të re, e cila ose ka rënë në dashuri, ose është detyruar të martohet me një emigrant i cili më pas forcërisht e ka detyruar atë të përfshihet në veprimtari të rrezikshme, trafikim, prostitucion etj.². Kjo nismë dhe studimet e rasteve janë

² Sipas Raportit mbi Praktikat e të Drejtave të Njeriut për vitin 2014, Shtetet e Bashkuara, Departamenti i Shtetit • Zyra për Demokraci, të Drejtat e Njeriut dhe Punës (raporti Shqipëri) - faqe 24. Për më shumë

një reflektim i aktiviteteve të organizuara në terren për të njohur këtë dukuri. Një njohje e mirë e problematikës së kësaj dukurie do të ndihmojë në orientimin e propozimeve për ndryshim/ përmirësim të politikave në nivel qendror, lokal dhe nevojën për angazhim të shoqërisë civile me qëllim trajtimin e martesave të hershme në përputhje me standartet dhe zgjidhjet më të mira ndërkombëtare.

Pasojat e martesës së hershme në mirëqenien fizike dhe emocionale të vajzave, dhe sidomos - siç është rasti në Shqipëri, me pasojë ndërprerjen e edukimit dhe privimin e saj nga mundësitë për zhvillim personal dhe profesional janë theksuar në kërkimin rajonal dhe global, ku UNFPA dhe UNICEF-i kanë qenë pararojë e këtyre përpjekjeve. Vlerësimi i këtij impakti negativ në jetën e vajzave/ grave ka sjellë në deklaratën UNICEF (2005) mbi martesat e hershme duke i përcaktuar si një praktikë e dëmshme e cila duhet të ndalet me çdo kusht. Deprivimi dhe mohimi i zhvillimit njerëzor, që shoqëron vajzat pas përfshirje së tyre në martesë të hershme përbën një shkelje flagrante të të drejtave të njeriut.³

informacion shikoni këtë link: <http://www.state.gov/j/drl/rls/hrrpt/humanrightsreport/#wrapper>

³ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ 1948) i referohet në mënyrë specifike vetëm rasteve të martesës së detyruar, pa pëlqimin e palëve, si një shkelje e së drejtës për të lidhur martesë “me pëlqim të lirë dhe të plotë” (neni 16 (2)). DUDNJ-ja gjithashtu thekson “Fëmijëria (është) një stad në të cilin kujdesi dhe mbrojtja e veçantë janë thelbësore” (Neni 25 (2)). Të njëjtat koncepte të së drejtës për të dhënë pëlqimin lirisht në martesë, dhe nevojën për masë të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve janë inkorporuar edhe në dy Konventat Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Kulturore dhe Sociale (1966) (Neni 10) dhe të Drejtat Politike dhe Civile (Art. 23 (3) Neni 24 (1). Konventa e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave

të Diskriminimit ndaj Grave 1979 (CEDAW) adresoi çështjen e martesës së fëmijëve në një nen të veçantë. Ajo sqaron se fejesa dhe martesë nuk do të kenë efekt ligjor dhe se shtetet palë duhet të caktojnë një moshë minimale për martesë dhe të sigurojnë një sistem për regjistrimin e detyrueshëm të martesës (neni 16 (2)). Komiteti i monitorimit të progresit të CEDAW ka miratuar rekomandime të përgjithshme për Barazinë në Martesë (GR 21) dhe shëndetin e grave dhe të vajzave (GR 24), të cilat vendosin standarde në detyrimet e Shteteve Palë për të parandaluar martesat e hershme. Këto norma janë përforcuar me Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës, 1989 (KDF). Principet e Konventës si e drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit, (Neni 6) dhe e drejta e regjistrimit të lindjes (neni 7) krijojnë detyrime mbi shtetin për të parandaluar martesat e hershme. Të drejtat për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi dhe abuzimi, dhe e drejta për pjesëmarrje në procesin e vendimarrjes në lidhje me jetën e tij/saj, me kapacitetin dhe pjekurinë evolutive, janë të drejta të cilat u mohohen me përfshirjen në martesën e hershme. Normat e përgjithshme të mosdiskriminimit në nenin 2 dhe interesi më i mirë i fëmijës në nenin 3, përforcojnë ndalimin e martesës së hershme dhe të detyruar. Ky interpretim është i përfshirë në Komentet e Përgjithshme të Komitetit të KDF, duke sqaruar, se martesat e hershme shkelin të drejtat e fëmijëve të përfshira në këtë instrument. Këto përfshijnë një Koment të Përgjithshëm mbi Shëndetin e adoleshentit (GC 2003 Nr 4, paragrafi 9, 20) dhe Komenti i Përgjithshëm Nr 3 mbi HIV / AIDS. Ky interpreton Nenin 6 mbi të drejtën për jetë dhe nevojën e marrjes së masave për mbrojtjen e vajzave dhe parandalimin e tyre në përfshirjen në martesë të hershme ose të detyruar, me arsyetimin se martesë e hershme i bën ata më vulnerabël ndaj HIV/ AIDS (GC 2003 Nr 3 Par 11).

Standartet e traktateve të të drejtave të njeriut janë zhvilluar gjatë një periudhe të shtrirë kohore, duke deklaruar unanimisht martesat e fëmijëve si një praktikë të dëmshme, të cilat duhet të eliminohen edhe nëse ajo është e miratuar dhe legjitimuar në të drejtën zakonore apo traditën. Martesë e fëmijëve është përshkruar në këtë mënyrë si një “praktikë e dëmshme tradicionale” në Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut. Neni 24 (3) të KDF i referohet detyrimit të një shteti palë për të “marrë masat e duhura dhe efektive për të ndaluar praktikat tradicionale të dëmshme për shëndetin.” Komenti i përgjithshëm

Ky studim, ngritur mbi dy raste studimore, përfaqëson dhe përfundimin e fazës së dytë të veprimtarive të organizuara nga “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve” në Shqipëri, dhe mbështetur nga Fondi Kanadez për Nisma Vendore. Kjo nismë, e ngritur mbi dukurinë e martesës së hershme, ka si qëllim që të vlerësojë qartë shtrirjen dhe intensitetin e saj në terren duke organizuar dhe ndërthurur aktivitetet në dy qytete kryesore të Shqipërisë: Korçë dhe Vlorë. Gjetjet e paraqitura këtu do të ndihmojnë në procesin e zhvillimit të një nisme mbarëkombëtare e cila synon eliminimin e kësaj dukurie negative për shoqërinë shqiptare duke përmirësuar në këtë mënyrë shanset për integrimin evropian të Shqipërisë edhe në aspektin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe atyre gjinore.

i KDF mbi HIV / AIDS (GC Nr 3, paragrafi 11) pranon se martesë e hershme vjen si një “praktikë e dëmshme tradicionale”. Komenti i Përgjithshëm mbi Shëndetin e Adoloshentit thekson rëndësinë e ndërhyrjeve për të vendosur një moshë minimale për martesën dhe dhënien e pëlqimit për marrëdhënie seksuale pa bërë dallime në bazë të gjinisë (GC Nr 4, paragrafi 9, 20). Kjo qasje është përforcuar në standardet e CEDAW. Neni 5 i kësaj Konvente kërkon që shteti të marrë hapa për të “Modifikuar” praktikat sociale, kulturore dhe zakonore që bien ndesh me të drejtën e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit. Disa prej Rekomandimeve të Përgjithshme të CEDAW-s, mbi Shëndetësinë (Nr 24), Dhunën ndaj Grave (No 19) dhe Barazinë në martesë (Nr 21) konsiderojnë martesat e hershme dhe të detyruara si një praktikë të “dëmshme”, që duhet të eliminohet, edhe nëse ajo është miratuar në kulturat lokale dhe zakonore. Edhe pse instrumentet e të drejtave të njeriut, duke përfshirë CRC pranojnë se fëmija e një komuniteti etnik minoritar ka të drejtë të gëzojë kulturën e tij / saj (CRC Art 30, Art ICCPR 27) dhe të drejtën e lirisë së besimit fetar (KDF Art 14, ICCPR 18) manifestimi i vlerave të asaj kulture dhe besimit fetar është subjekt i detyrimit që Shteti Pale ka për t’i monitoruar dhe modifikuar ato kur vëren se praktikat shkelin të drejtat e tjera të njeriut.

Zhvillimet e fundit politike në Shqipëri, duke përfshirë krijimin e një qeverie të krahut të majtë (2013) dhe përshpejtimi i procesit drejt integritit evropian kanë krijuar mundësi të reja për të rishqyrtuar dhe hartuar politika edhe më të mira publike duke adresuar njëkohësisht çështjet e martesave të hershme dhe feminare. “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”, i angazhuar në këtë nismë, qëndron në pararojë të gjetjes së zgjidhjeve pragmatike në bashkëpunim me qeverinë dhe partnerët ndërkombëtarë. Ne jemi të mendimit se reforma e re territoriale që Shqipëria po zbaton do të ofrojë mundësi dhe avantazhe edhe më të mëdha për t’u marrë me çështjen e martesave të hershme në nivel lokal. Krijimi i njësie të unifikuara të qeverisjes vendore me qëllime dhe detyra të përcaktuara qartë do të sigurojë në terma afatgjatë struktura më efektive për t’u marrë me të drejtat e njeriut, duke përfshirë mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtave të tyre. Kështu, qeveria qendrore, përfaqësuesja e Shqipërisë në forume dhe organizata ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, duhet të hartojë politika të qarta të cilat të mund të zbatohen ashtu si duhet nga qeverisja vendore dhe strukturat e tjera e në këtë mënyrë të adresohet me efektivitet dukuria e martesave të hershme dhe pasojat e tyre.

B. Fasada e dritëshkurtësisë në politikat për martesën dhe familjen

Mosha e lejuar ligjore për martesë në Shqipëri është 18 vjeç, pavarësisht nga feja, ndërsa mosha e lejuar për marrëdhënie seksuale konsensuale (dakortësie) është 14

vjeç⁴. Ky lloj rregullimi, e rendit Shqipërinë në grupin e vendeve me një prag të ulët të moshës në të cilën pëlqimi konsensual seksual përjashton ndjekjen ligjore për dhunë/ ngacmime seksuale kundrejt fëmijëve mbi 14 vjeç në kushtet kur ky konsensus/ pëlqim për pjesëmarrje në aktivitetin seksual ka ekzistuar. Në këtë grup vendesh (pra me të njëjtën moshë minimale konsensuale) renditen të gjitha vendet fqinje, me përjashtim të Greqisë.

Ndërsa zhvillonim vlerësimin e kuadrit ligjor, politikave aktuale, raporteve të hartuara nga organizata vendase/ të huaja, pasqyrimeve mediatike dhe reflektonim mbi gjetjet e studimit të kryer mbi martesat e hershme në komunitetet etnike rome, vumë re se marrëdhëniet seksuale me të mitur nën moshën 14 vjeç kanë ekzistuar por nuk janë përcaktuar qartë apo konsideruar si një vepër penale-përdhunim. Kodi Penal shqiptar shprehet se të miturit nën moshën 14 vjeç nuk kanë kapacitet ligjor për të shprehur pëlqimin.⁵ Nga ana tjetër, nëse urdhërohet nga gjykata, i

⁴ Bazuar në një shqyrtim të burimeve të ndryshme që merren me moshën konsensuale për të hyrë në një marrëdhënie seksuale- 16 vjeç duket të jetë moshë dominuese në botë. Shqipëria dhe vendet fqinje, duke përfshirë Italinë kanë vendosur moshën e pëlqimit në moshën 14 vjeçare. Greqia e ka vendosur moshën 15-vjeçare Për më shumë informacion shihni: <http://www.ageofconsent.com/ageofconsent.htm>

⁵ Moshë e pëlqimit në Shqipëri është 14 vjeç. Kjo është moshë minimale në të cilën një individ konsiderohet ligjërisht i rritur mjaftueshëm për të dhënë pëlqimin për pjesëmarrje në aktivitetin seksual. Individët e moshës 13 vjeç ose më të vegjël në Shqipëri nuk janë ligjërisht në gjendje të japin pëlqimin për aktivitetin seksual, dhe një akt i tillë mund të rezultojë në ndjekje penale për përdhunim. Ligji quhet i shkelur kur një individ ka kontakte seksuale me një person nën moshën 14. Për më shumë informacion shihni: <https://www.ageofconsent.net/world/albania>

mituri mund të hyjë në një martesë dhe kjo automatikisht e konsideron të miturin si një të rritur me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë që ai do të fitonte me rritjen normale. Ky paradoks në dukje ligjor midis kodit penal dhe atij të familjes së bashku me praktikën ligjore dhe ilegale të martesave të hershme ishin disa prej faktorëve nxitës që na drejtuan drejt eksplorimit të mëtejshëm në mënyrë që të kuptonim jo vetëm ndryshimet që kultura lokale e martesës ka pësuar që nga fillimi i tranzicionit socio-politik (1991) por edhe të analizonim pasojat sociale të kësaj dukurie.

C. Pse kjo nismë dhe rastet studimore?

Një tjetër e dhënë statistikore e ofruar nga organizata Save the Children tregon se nga numri total prej 604,000 adoleshentë (10-19 vjeç), rreth 8% (48,320) janë të martuar/ në lidhje.⁶ Edhe nga analiza e të dhënave të ofruara nga UNFPA dhe UNICEF, shifrat ndoshta nuk duken kërcënuese, por mund të bëhen alarmante për të ardhmen- si përsa i përket kostove shëndetësore ashtu dhe atyre sociale- nëse nuk ndërmerren masat e duhura për të parandaluar martesat e hershme dhe mbështetur zhvillimin e programeve mbështetëse, ri-integruese për vajzat/ gratë e përfshira në këto martesë, me qëllim zhvillimin e tyre të mëtejshëm personal dhe profesional.

Studimi i mbështetur nga Fondi Kanadez për Nismat Lokale u përgatit bazuar në argumentet e mëposhtëm:

⁶ Për më shumë informacion shih: <http://resourcecentre.savethechildren.se/countries/albania>

1. Siç edhe kemi përmendur në këtë studim përfshirja e aktorëve të tjerë shqiptarë në këtë çështje ka qenë pothuajse e papërfillshme dhe e kufizuar vetëm në evidentimin e statistikave të cilat kërkohen në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe përputhshmërisë me standardet e këtyre marrëveshjeve. Studimet në lidhje me këtë çështje janë të kufizuara dhe të fokusuara kryesisht tek minoriteti etnik rom ashtu siç ishte edhe fokusi i “Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve” gjatë fazës së parë të kësaj nisme.⁷
2. Ne besojmë se informaliteti/ ilegaliteti që ka mbizotëruar situatën e përfshirjes së fëmijëve në martesat e hershme sidomos në kontekstin e ri social të pas viteve ‘90, kur shteti u distancua prej rolit atëror dhe kontrollit të tij të zgjeruar mbi marrëdhëniet shoqërore, martesën dhe familjen, mund dhe duhet të adresohet. Traditat, të menduara si të çrrënjësura, të tilla si “martesa në djep” apo martesat e hershme u rishfaqën edhe si pasojë e krizave ekonomike dhe vështirësive financiare me të cilat u ndeshën familjet shqiptare gjatë tranzicionit.⁸

⁷ Studimi i kryer gjatë fazës së parë mund të gjendet në: http://observator.org.al/ep-content/uploads/2015/03/2015-Child_marriage_in_Albania.pdf

⁸ Një autor si Clarissa de Waal në librin e saj “*Shqipëria Sot: Një portret i trazirave postkomuniste*” merret me çështjen e traditave të shtypura dhe rolin paternalist të shtetit duke e konsideruar çështjen në fjalë si një rishfaqje të traditave të prapambetura të së kaluarës. Një tjetër autor, Artan Fuga, merret me këtë çështje në studimin e tij në lidhje me migrimin e brendshëm në Shqipëri: “*Identité périphériques en Albanie*”

3. Në një këndvështrim më pozitiv të situatës evidentohen edhe disa zhvillime, të tilla si ndryshimi i Kodit të Familjes i cili është amenduar në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ekzistenca e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve⁹ dhe e Institucionit të Avokatit të Popullit tregojnë se janë hedhur hapat e parë zyrtarë drejt krijimit të një mjedisi mbrojtës së të drejtave të fëmijëve, duke përfshirë mbrojtjen nga abuzimi seksual dhe forma të tjera të abuzimit. Angazhimi aktiv i agjencisë në nivel lokal dhe zbatimit në terren i të drejtave të fëmijëve është ende në fazat e hershme për shkak të riformatimit të strukturave të qeverisjes lokale dhe mungesës së stafit me përvojë në këto struktura.
4. Efektet negative të martesës së hershme kanë tendencë të manifestohen në statet e mëvonshme të zhvillimit jetësor, duke përfshirë çështjet që lidhen me shëndetin dhe mirëqenien psikologjike.¹⁰ Në Shqipëri

⁹ Për më shumë informacion shih: <http://femijet.gov.al/al/>

¹⁰ **Vdekshmëri e lartë e nënave gjatë lindjes.** Ky është një ndër problemet më serioze të martesave të hershme. Vajzat që janë të martuar para 18, shpesh do të kenë fëmijë shumë më herët se ato të jenë të pjekura fizikisht për të përballuar me sukses shtatëzëninë dhe procesin e lindjes. Çdo vit, 13.7 milion vajza të moshës 15-19 vjeç lindin fëmijë dhe komplikimet e evidentuara në shtatëzëni dhe lindje janë vrasësi kryesor i vajzave në këtë grupmoshë në vendet në zhvillim. Fëmijët e martuar kanë gjithashtu një shkallë më të lartë të prekjës nga HIV/ AIDS dhe SST të tjera krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre të pamartuar, duke paraqitur parametra të ulët shëndetësore dhe vdekje të parakohshme.

• **Rritje e vdekshmërisë foshnjore.** Nënadoleshente kanë më shumë gjasa për të pasur lindje të parakohshme ose të humbin fëmijën

efektet negative të martesave të hershme theksohen edhe më tepër nga ndërthurja e tyre me emigracionin e paligjshëm, trafikimin dhe forma të ndryshme të shfrytëzimit njerëzor.

5. Ky dokument është rezultat i një nisme që nisi me studimin e dukurisë të martesave të hershme në komunitetet rome. Procesi u bazua në konkluzionet dhe gjetjet e fazës së parë duke u fokusuar në njohjen e tipareve shqiptare të dukurisë. Realisht, dukuria i kapërcen kufijtë etnikë dhe shfaqet edhe në shumicën e popullsisë, i zhvilluar kryesisht si rezultat i paradoksit ligjor ndërmjet parashikimit ligjor mbi moshën minimale të dhënies së pëlqimit për pjesëmarrje në aktivitet seksual dhe vendimeve aprovuese të siguruara në gjykata. Gjithashtu, mësuam se Shqipërisë i është kërkuar, në kuadrin e CEDAW¹¹, të marrë në konsideratë

gjatë shtatzënisë. Fëmijët e tyre kanë risk më të lartë për vdekje në foshnjëri. Normat e vdekshmërisë foshnjore tek nënat nën moshën 20 vjeç janë 50% më të larta sesa ato mbi 20 vjeç.

• **Mungesa e edukimit.** Shpesh mund të ndodh të neglizhohet, por kur bëhet fjalë për problemet e martesave të hershme, efektet në arsimimin e vajzave janë të thella. Pasi martohen, vajzat tërhiqen nga shkolla, dhe jeta e tyre dominohet nga kujdesi për fëmijët dhe punët shtëpiake. Vajzat e nënave të reja kanë gjithashtu më shumë gjasa të braktisin shkollën dhe të martohen herët.

• **Rreziku i lartë i dhunës.** Martesa e hershme shpesh privon një vajzë nga të drejtat e saj, liria dhe zgjedhjet. Ato kanë më shumë gjasa të jenë viktimat të abuzimit fizik dhe seksual.

Shih më shumë në: <http://www.plan-uk.org/because-i-am-a-girl/early-and-forced-marriage/early-child-marriage-problems-and-consequences/#sthash.t9EizXE6.dpuf>

¹¹ Për më shumë informacion: http://www.un.org.al/editorfiles/file/CEDAW_C_ALB_4th%20report_Nov%202014_En.pdf

këtë çështje dhe të raportojë mbi të. Ndërsa organizatat e OKB-së janë orientuar drejt aspekteve ligjore të çështjes duke zhvilluar trajnime për gjyqtarë dhe noterë me qëllim adresimin efektiv të dukurisë së martesave të hershme, ne vlerësuam me përparësi nevojën imediate të kryerjes së një studimi mbi martesat e hershme si një manifestim i shumicës së popullsisë me rrënjët e saj të shtrira thellë në histori dhe të ushqyera rishtazi nga faktorë socialë mjaft dinamik.

6. Në mënyrë që të zhvillohen politika të informuara është e nevojshme që politikë-bërësit të jenë të bindur mbi rëndësinë e ndryshimeve që ne propozojmë duke kuptuar se çështja e martesave të hershme meriton më shumë vëmendje dhe se kjo nismë duhet të shtrihet në nivel kombëtar. Ky dokument dhe nisma na krijojnë mundësinë të reflektojmë mbi kostot sociale të tranzicionit tek familjet shqiptare. Ky reflektim dhe mënyra se si jemi përballur me tranzicionin dhe pasojat e tij, na nxisin të konsiderojmë dy ndërhyrje të rëndësishme- e para lidhet me rishikimin ligjor të moshës minimale për dhënie e pëlqimit për pjesëmarrje në aktivitet seksual, duke propozuar rritjen e saj në 15 vjeç dhe tjetri i orientuar drejt adresimit të nevojave sociale dhe edukative për të fuqizuar statusin dhe produktivitetin e vajzave/ grave të përfshira në martesa të hershme, jo vetëm në familje por edhe në shoqëri.

D. Pse u përfshi “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”?

“Observatori për të Drejtat e Fëmijëve” me mbështetjen e Fondit Kanadez për Nismat Lokale vazhdoi punën e nisur në fazën e parë e cila fokusohej në studimin e dukurisë në komunitetet rome. Kjo organizatë punon në fushën e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, monitoron dhe raporton me profesionalizëm mbi çështjet që shqetësojnë realizimin e këtyre të drejtave nëpërmjet 12 zyrave rajonale të ngritura në secilin qark (rajon) të Shqipërisë. Observatori bashkëpunon ngushtë me njësitë e qeverisjes vendore, ministritë e linjës dhe donatorët ndërkombëtarë që punojnë për mbrojtjen dhe përmirësimin e situatës së të drejtave të fëmijëve.

Aktualisht, Observatori në bashkëpunim me UNICEF dhe Ministrinë e Arsimit dhe të Sporteve është duke zbatuar fazën pilot të një projekti kombëtar që synon të identifikojë të gjithë fëmijët të cilët për arsye të ndryshme nuk frekuentojnë shkollën ose e kanë braktisur atë dhe t’i integrojë ata në sistemin arsimor. Observatori, në të njëjtën kohë po kontribuon me ekspertizën e tij në Komisionin për të Drejtat e Fëmijëve, lidhur me rekomandimet dhe planet në kuadër të hartimit të raportit të ardhshëm të CEDAW, me fokus të veçantë në çështjet që lidhen me martesat e hershme të fëmijëve. Prezenca aktive në nivel lokal në të gjitha rajonet e Shqipërisë dhe bashkëpunimi efektiv me strukturat e qeverisjes vendore, me strukturat policore, shëndetësore dhe arsimore shërbyen si një mbështetje e fortë në mbledhjen e të dhënave të besueshme dhe në kohë rekord për këtë studim.

“Observatori për të Drejtat e Fëmijëve” synon të angazhojë më tej institucionet e qeverisjes lokale dhe aktorëve kyç në një proces të bashkërenduar për të adresuar dukurinë e martesave të hershme në shkallë kombëtare duke vlerësuar sinergjinë e cila mundëson progresin e politikave sociale, konkretisht për të parandaluar dhe eliminuar dukurinë në fjalë pa neglizhuar edhe kostot sociale të mbartura gjatë periudhës tranzitive sidomos në aspektet e edukimit dhe zhvillimit profesional. Propozimet e këtij studimi pritet të replikohen si në shkallë rajonale ashtu edhe kombëtare.

E. Arsyetimi i përzgjedhjes së Korçës dhe Vlorës

Bashkitë e Korçës dhe të Vlorës po përjetojnë zhvillim ekonomik të dukshëm, i lidhur ky kryesisht me zhvillimin e turizmit dhe bujqësisë por fatkeqsisht ky zhvillim nuk është reflektuar edhe në rritjen e mundësive për gratë. Ne filluam këtë projekt duke synuar *fuqizimin e mekanizmave të mbrojtjes së fëmijëve* dhe përmirësimin efektivitetit të shërbimeve komunitare për të identifikuar, mbështetur dhe referuar rastet e fëmijëve dhe familjeve të përfshira në martesat e hershme apo të detyruara. Një arsye tjetër e përzgjedhjes së rajoneve Korçë dhe Vlorë lidhet me pozicionin e tyre gjeografik si zona kufitare, të cilat janë ndikuar ndjeshëm nga trafikimi i të miturve, vajzave dhe grave. Sipas ndarjes së re administrative, Bashkia e re e Vlorës përfshin më shumë zona rurale (fshatra), ku mbizotëron mentaliteti dhe praktika e martesës nën moshën 18 vjeç.

Korça nga ana tjetër, përfaqëson shkëndijën prej nga lindi ideja e këtij projekti, ndërsa po zbatonim një nismë tjetër tonën, atë të mundësimit të frekuentimit të kopshtit prej çdo fëmijë Rom. Gjatë këtij procesi vumë re se shumë prej nënave ishin shumë të reja madje shpesh nën 18 vjeç. Kjo dukuri e përhapur jo vetëm në komunitetin rom, por edhe në komunitetet e tjera është kritikuar mjaft gjatë periudhës së rilindjes shqiptare, në fund të shekullit të 19-të.¹² Për më tepër Korça është një rajon që ka një kufi me Greqinë- një rrugë e shfrytëzuar shumë në të kaluarën për emigracion të paligjshëm dhe trafikim.

Në një këndvështrim pozitiv, ajo që përbënte avantazh në ndërhyrjen që ne planifikuam dhe implementuam me sukses ishte rrjeti i ngritur i bashkëpunëtorëve lokalë, gadishmëria dhe vullneti i tyre për t'u angazhuar drejt adresimit të çështjes së martesave të hershme.

¹² Një shkrimtar i rëndësishëm i Lëvizjes Rilindase Kombëtare, Andon Zako Çajupi, e trajtoi çështjen e martesave të hershme në një kontekst gjinor. Ai shkroi një komedi / poemë të titulluar “14 Vjeç dhëndër”, në të cilën ai kritikoi praktikën e martesës së djemve në moshë të mitur, një praktikë e cila synonte shfrytëzimin e grave të tyre si punëtore të papaguara, të cilat duhet të merreshin me punët e shtëpisë dhe bujqësisë.

III. Metodologjia, Burimet dhe Hendeqet Kërkimore

A. Metodologjia kërkimore

Për të analizuar në mënyrë të plotë dhe efektive dukurinë e martesave të hershme si një fenomen shoqëror, dhe jo thjesht si një tregues statistikor që kërkohet ndërkombëtarisht ne vendosëm të ndalemi në studimin e rasteve dhe të organizojmë në terren aktivitete të ndryshme në funksion të një analize të detajuar të kontekstit social, respektivisht në Bashkitë e Korçës dhe Vlorës. Modeli kërkimor i studimit të rastit (rasti studimor) orienton vëmendjen e të gjithë aktorëve, si atyre familjarë, komunitarë, vendimarrës dhe ofrues shërbimesh si dhe vetë protagonisteve të përfshira në “martesat e hershme” tek kjo eksperiencë duke e parë atë si një përvojë që është në proces zhvillimi. Kjo metodologji largohet nga stereotipet apo klishetë e vërejtura në përjasjet e deritanishme ndaj dukurisë duke na siguruar një vizion të gjerë 360 gradë dhe mjaft të qartë të situatës. Për më tepër qasja e përdorur në vëzhgimet mbi martesat e hershme në Korçë dhe Vlorë na lejon (krijon mundësi) për sa më poshtë:

1. Për të identifikuar këtë çështje dhe për të hedhur themelet e mbledhjes së të dhënave në mbarë vendin

me anë të një metodologjie të provuar për SAKTËSINË dhe BESUESHMËRINË. Me anë të saj eliminohet problemi i të prodhuarit të statistikave sipërfaqësore.

2. Ne nuk e konsiderojmë “martesën në moshë të mitur” si variable të pavarur, por si dhimbje sociale që kërkon trajtim. Gratë që janë duke e jetuar martesën e hershme paraqiten si një nën-shtresë sociale që është vecanërisht e mekur si rezultat i të jetuarit brenda kufijve të shtëpisë a rrugës si pasojë e tretjes së lidhjeve shoqërore që këto vajza kishin para se të nisnin një martesë të hershme.¹³
3. Përgatitëm një pyetësor të dhënë drejt evidentimit të rezultateve të pavetëdijshme, e gjatë takimeve stafi intervistues ishte i vëmendshëm për të dokumentuar momentet kur të anketuarit arrinin të ndërjegjësoheshin për sjellje të caktuara duke kuptuar më mirë lidhjet shkaku-pasojë ndërmjet tyre. Edhe pse atyre nuk ju kërkua një opinion i drejtëpërdrejtë vlerësues, pothuajse shumica e tyre artikuluan qartë faktin se martesa e hershme nuk është një gjë pozitive.
4. Mbledhja e të dhënave nuk është bërë në një ditë. Kemi ndërtuar një marrëdhënie që rritet me pjesëmarrëset në sondazh të cilat kërkojnë më shumë mundësi për veten e tyre dhe gjetjen e rrugëve për t’i arritur këto mundësi.

¹³ Për më shumë informacion në lidhje me problemet sociale dhe shëndetësore që lidhen me martesat e hershme, ju lutem konsideroni artikullin nga:

Nawal M Nour ‘Child Marriage: A Silent Health and Human Rights Issue’ mund të gjendet këtu: <http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC2672998/>

5. Siç u theksua më herët ne u përpoqëm të shmangnim “atë që dukej sheshit” duke përdorur forma të rrugëve të ndryshme të përpunimit të të dhënave të mbledhura për të patur mundësinë për të testuar vlefshmërinë parashikuese në kuadrin e procesit të zhvillimit të standardeve për një studim mbarëkombëtar, nëpërmjet disa kampionëve të testuar përgjatë një periudhe të caktuar kohore, përfshirë këtu edhe testimin e rezultateve të pritshme të politikave/ ndryshimeve ligjore dhe sociale me synim frenimin/ eliminimin e martesave të hershme.
6. Kemi vënë re se asnjë rast i martesës së hershme nuk ngjason me tjetrin në kushte të përvojës konjitive (njohëse) duke konkluduar në bindjen e fortë se ato mund të ishin parandaluar ose mund të ishin menaxhuar më mirë. Ne kuptuam se dija e përfutur në kontekst lokal (Korçë dhe Vlorë, në këtë rast) është e çmuar dhe kërkon zhvillimin e ndërhyrjeve në terren dhe të një kërkimi që përshtatet me tipologjinë specifike të mjedisit.
7. Metodologjia e aplikuar orienton rezultatet përse i përket vendimmarrjes dhe përfshin të menduarit sistemik në lidhje me çështjen duke konsideruar dhe vlerësuar të gjitha aspektet e problemit. Ajo krijon mundësi për ndërhyrje shumëpalëshe duke rritur shanset për zbatimin e suksesshëm të politikave.
8. Duke pasur parasysh jetëgjatësinë e kësaj nisme, pra përtej këtyre rasteve studimore (fazës pilot) kjo metodologji na ndihmon t’u japim përgjigje dy pyetjeve kryesore: (1) Si vendimmarrësit mund të përmirësojnë vendimet e tyre dhe (2) Si mund të ndihmohen vajzat-

fëmijë të marrin vendime më racionale kur ndodhen përballë mundësisë së përfshirjes në një martesë të hershme.

9. Struktura e këtij studimi përfshin propozime mbi politikat që ndihmojnë në procesin e hartimit të axhendës dhe marrjes së vendimeve për këtë çështje me synimin e adresimit të nevojës për rritjen e ndërgjegjësimit mbi martesat e hershme në komunitetet lokale.
10. Ne kemi zhvilluar edhe skemën vizuale “problematika e martesave të hershme”, si një mjet ndihmës drejt konceptualizimit më të qartë të situatës dhe busulle orientuese në propozimin e ndërhyrjeve më efektive të politikave. Nëpërmjet saj evidentohen gjithashtu hendeqet që ekzistojnë në politikat dhe praktikën e martesave të hershme në Shqipëri.


B. Problematika e Martesave në Moshë të Hershme dhe Fëminore

1. Termi “*problematikë*”, koncept i huazuar nga gjuhët sllave, nënkupton identifikimin e kushteve, zhvillimeve apo dukurive, të cilat mund të gjurmohen në lidhje me një çështje të caktuar. Në rastin e këtij punimi është martesa e hershme, çështja të cilën ne kërkojmë të eksplorojmë, duke e identifikuar së pari si një përvojë personale e vajzave/grave të cilat aktualisht jetojnë në dy zonat e përzgjedhura për pilotim. Problematika e martesave të hershme përbëhet nga tre kategori kryesore të cilat mund të ndahen në nënkategori të tjera me elementë më specifik.

2. Qendra e skemës korrespondon me objektivat kryesore të projektit.
 - a. Kutia e parë përfaqëson: Identifikimin e një numri të konsiderueshëm grash të përfshira në martesat e hershme me qëllim eksplorimin e ndikimit të kësaj dukurie në jetën e tyre personale dhe familjare krahas identifikimit të modeleve të marrëdhënieve sociale që ajo ka krijuar, përfshirë këtu numrin e fëmijëve dhe të dhëna të tjera sasiore.
 - b. Kutia e dytë përfaqëson: Tiparet e martesave të hershme si përvojë cilësore e përjetuar në Shqipëri. Nëpërmjet pyetësorëve, fokus grupeve dhe mbledhjes së të dhënave zyrtare synohet të evidentohet se çfarë përfaqësojnë këto gra; kualifikimet profesionale dhe aftësitë, arsyet e zgjedhjes së tyre, pritshmëritë rreth vetes dhe familjes së tyre. Pyetja që lind është se ku dhe çfarë ndryshimesh duhet të ndodhin në sistemin formal të arsimimit, kuadrit ligjor dhe zhvillimit të komunitetit në mënyrë që kjo dukuri të mund të parandalohet?
3. Në anën e majtë të figurës renditen gjashtë argumentet/faktorët shtytës kryesorë më shqetësues, determinante për situatën e grave të përfshira në martesa të hershme dhe për komunitetin afër tyre:
 - a. I pari lidh martesën në moshë të mitur me pasojat e zhvillimit të pabarabartë në vende të tilla si Shqipëria ku PBB¹⁴ e rendit atë lart ndërmjet vendeve me të ardhura mesatare e në anën tjetër ndodhin këto lloj dukurish. Koncepti i barazisë

¹⁴ Për më shumë shih: <http://data.worldbank.org/country/albania>

aplikuar gjatë kohës së diktaturës komuniste nuk bëri gjë tjetër veçse i barazoi njerëzit në varfëri dhe mungesën e mundësive. Tranzicioni krijoi mjaft mundësi për pasurimin në të gjitha mënyrat, legale apo ilegale. Ndërsa, dimë që zhvillimi ekonomik ecën shpesh me ritme shumë më të shpejta sesa zhvillimet sociale, ndryshimin e botkuptimit individual, rregullave sociale etj. Në këtë situatë ndodh që zona apo aspekte të caktuara të vendit të mbeten në prapambetje të theksuar, e reflektuar sidomos në drejtim të emancipimit shoqëror. Edhe standardet dhe normat ekzistuese u zbehën duke humbur vlerat e tyre dhe lënë hapësirë zhvillimi për dukuri të tilla si martesat e hershme.



Grafikë 1: Problematika e martesave të hershme

- b. Një tjetër arsye predispozuese e martesave të hershme lidhet me korupsionin e vlerave në familje dhe atë në sistemin e drejtësisë. Pavarësisht zhvillimeve të fundit pozitive lidhur me perceptimin e korupsionit, fatkeqësisht Shqipëria mbetet një vend ku kjo dukuri është brendësuar si tipar i kulturës. I depërtuar edhe në çështjet e martesave të hershme, ndodh të ndeshemi me prindër të cilët “bindin” fëmijët për këto zgjedhje, i detyrojnë shpesh të gënjejnë për të dhënë miratimin individual apo në rastet kur këtë gjykim e merr në dorë gjykata e rrethit përkatës, ndodh të neglizhohet shqyrtimi i interesit më të lartë të fëmijës, pa marrë në konsideratë pasojat afatgjata në jetën e tyre dhe duke lejuar në vijimësi shkeljen e shumë prej të drejtave të tjera.
- c. Një arsye e tretë lidhet me dukurinë si një produkt i tranzicionit të tejzgjatur i shoqëruar me deformime të sjelljes si rezultat i pasigurive dhe pabarazive të ndjeshme. Në situata të tilla, të mungesës së strukturave rregullatore, monitoruese dhe mbështetëse, njerëzit kanë tendencën të gjejnë zgjidhje individuale duke zhvilluar normat dhe rregullat e tyre. Kjo reflektohet edhe në zgjimin e dukurisë së martesave të hershme Shqipëri pas më shumë se gjysëm shekulli.
- d. Një tjetër argument shqetësues lidhet me perceptimin e martesave të hershme si një efekt anësor i një tradite “të ringjallur” dhe shfrytëzimi i tyre nga njerëzit dhe komunitetet për të justifikuar kursin e tyre të veprimit dhe detyruar vajzat e

reja të pranojnë marrëdhënie të tilla. Zakonet e martesës së hershme në Shqipëri u çrrënjosen nëpërmjet hapave progresivë të marra nga sistemi komunist, në kuadrin e lëvizjes për emancipimin e grave¹⁵. Shqetësimi ynë lidhet pikërisht me faktin se një model i ri po zhvillohet si në Shqipëri dhe në Evropën Juglindore, nga njëra anë kemi komunitetet që e praktikojnë këtë martesë duke e paraqitur si një rikthim tek tradita, ndërsa në anën tjetër kemi rritjen e moshës mesatare të martesës¹⁶ e cila shkon në përputhje me trendin normal në mbarë botën e industrializuar.

- e. Në një tjetër qëndrim ne jemi të njëjtë mendim me studiues të tjerë që punojnë mbi këtë çështje: që martesat e hershme shpesh është një formë moderne e skllavërisë për vajzat dhe gratë. Sipas grupit të punës së OKB-së për Format Bashkëkohore të Skllavërisë, martesat e hershme dhe të detyruara janë një formë skllavërie dhe në shumë raste paraqesin varësinë e grave nga burrat dhe përbën një akt të pastër të diskriminimit ndaj tyre.¹⁷

¹⁵ Routledge International Encyclopedia of Women: Global Women's Issues and Knowledge, nga Kramarae and Spender, faqe 751

¹⁶ Mosha mesatare e martesës për femrat në Shqipëri është rritur në 23 vjeç, sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2011. Për më shumë informacion mbi këtë mund të konsultoheni me studimin e INSTAT (faqe 25), të cilin mund t'a gjeni në:

http://www.instat.gov.al/media/258326/perspektiva_gjinore_n_shqip_ri.pdf
http://www.instat.gov.al/media/258326/perspektiva_gjinore_n_shqip_ri.pdf

¹⁷ UNHCR (Sub-Commission), 'Raport i Grupit të Punës mbi Format

- f. Megjithatë, kjo mund të shihet edhe si pasaportë për sigurinë financiare dhe ekonomike. Ky besim i përhapur, veçanërisht në komunitetet ku praktikohet martesat e hershme mbetet për t'u provuar shkencërisht.¹⁸

4. Ana e djathtë e figurës lidhet me veprimin: Çfarë kanë bërë dhe çfarë mund të bëjnë aktorët në fusha të ndryshme për të adresuar çështjet që lidhen me martesat e hershme. Çfarë mund dhe çfarë duhet të bëhet për të arritur rezultate më të mira duke marrë parasysh dhe gjetjet e këtij studimi? Në anën e djathtë, ne kemi parasysh tre kategoritë kryesore të aktorëve (të paraqitur në 3 rrathë), të cilët kanë mundësi jo vetëm të ngrenë zërin e tyre por edhe të mundësojnë ndryshimet e nevojshme në realitet (ata duhet të marrin përgjegjësitë përkatëse), në mënyrë që objektivat dhe qëllimet e vendosura të përmbushen maksimalisht:

- a. Rrethi i parë përfaqëson OSHC (Organizatat e Shoqërisë Civile dhe ON (Organizatat Ndërkombëtare) që punojnë Korçë dhe Vlorë (si "Observatori për të Drejtat e Fëmijëve" dhe partnerët e tij). Pyetja që të lind menjëherë është: çfarë politikash janë hartuar dhe sesi po zbatohen ato në këto dy zona? Përgjatë procesit të analizës së situatës dhe veprimeve të ndërmara na lindi një pyetje kritike: çfarë aksionesh mund të ndërmerren (inovative por edhe realiste) të

Bashkëkohore të Skllavërisë në sesionin e 28th (2003) UN Doc E/CN.4/Sub.2/2003/31, 5

¹⁸ Për më shumë informacion shihni: <https://www.givingwhatwecan.org/research/charities-area/child-marriage>

cilat të promovohen dhe të implementohen me qëllim përmirësimin e situatës shoqërore dhe arsimore të grave që janë në një martesë të hershme? Nga ana tjetër, çfarë mund të bëjmë për të filluar ndryshimin e politikave në mënyrë që të kufizohet numri i martesave të hershme, duke filluar me gjykatat dhe vazhduar me ndryshimet ligjore përsa i përket rritjes së moshës së pëlqimit konsensual për pjesëmarrje në aktivitet intim? Me cilët duhet të bashkëpunojmë, cilët janë grupet e interesit dhe aktorët politikë me të cilët na duhet të bashkërendojmë veprimet për të arritur këto qëllime? Prezantimi i problemeve në këtë mënyrë na orienton drejt zgjidhjes në prizmin e politikave duke lënë mënjanë emocionet.

- b. Rrethi i dytë, mjaft i shtrirë, përfaqëson aktorët qeveritarë, legjislativin dhe ekzekutivin, strukturat në nivel qendror të cilët në mënyrë direkte apo indirekte kanë përgjegjësinë e tyre përsa i përket frenimit/eliminimit të fenomenit të martesave të hershme. Në njërën anë kemi Ministrinë e Rinisë dhe Mirëqenies Sociale: Cilat janë vendimet e deritanishme në vijim të raporteve të CEDAW dhe KDF, në lidhje me martesën e hershme? Me cilat Ministri të linjës është bashkëpunuar? A është hartuar ndonjë strategji specifike apo zgjidhje specifike janë inkorporuar në ndonjë prej strategjive ekzistuese? Cilat janë hapat që QSh (Qeveria Shqiptare) mund dhe duhet të ndërmarrë për të trajtuar efektivisht çështjet që lidhen me martesat e hershme mbështetur në një vendimarrje

të informuar bazuar në rezultatet e këtij studimi apo dhe të një studimi mbarëkombëtar?

- c. Rrethi i tretë dhe i fundit përfaqëson mjedisin lokal që përmbledh një grup më të madh të palëve të interesuara. Sinergjitë e krijuara në këtë grup janë thelbësore në procesin e arritjes së rezultateve efektive që mund të arrihen si funksion i zbatimit të propozimeve tona në këtë studim, dhe që njëkohësisht luajnë rol në nxitjen e trajtimit të çështjes në axhendat e politikëbërësve. Një aktor i rëndësishëm është administrata e qeverisjes vendore që merret me të drejtat e fëmijëve, nga e cila kërkohet të ketë një koordinim më të mirë me policinë, spitalet, gjykatat, shkollat, mediat, mbështetur edhe nga OSHC me qëllim parandalimin apo adresimin e problemeve të individëve të përfshirë në këto martesë. Ekziston edhe një pyetje tjetër: ç’nivel sinergie ekziston ose mund të nxitet dhe të mbështetet më tej ndërmjet këtyre strukturave dhe përfituesve të drejtëpërdrejtë, në mënyrë që vendimet formale të mos mbeten në nivel thjesht formal, por të mundësojnë ndryshime efektive dhe efikase të mjedisit duke ofruar përmirësim të situatës së vajzave/grave të përfshira në martesë të hershme në njërën anë dhe nga ana tjetër të parandalojnë martesat potenciale që mund të ndodhin në atë komunitet.
5. Së fundmi, elementi në bazë të figurës, evidentohet si një shqetësim ndërsektorial në përputhje me objektivat e kësaj inisiativë: Si të vlerësohen hendeqet në kuadrin

ligjor dhe gjithashtu inkoherencat ndërmjet politikës dhe aktualitetit? Si mund të adresohen këto mangësi në të ardhmen dhe për të gjithë vendin?

C. Kërkimi Shkencor dhe Burimet

Ky dokument, i mbështetur në një punë intensive në terren dhe intervistat me vajzat/ gratë e përfshira në martesat e hershme në Korçë dhe Vlorë, u parapri nga një kërkim dhe shqyrtim paraprak i materialeve elektronike dhe atyre të botuara të tilla si studime dhe dokumente politikash që lidhen me martesat e hershme në Shqipëri dhe në mbarë botën. Diskutimet, informacioni dhe të dhënat e mbledhura nga aktivitetet e organizuara në çdo bashki u analizuan imtësisht duke synuar sintetizimin e informacionit dhe statistikave ekzistuese. Ky aktivitet ndihmoi për të bërë një pasqyrim të plotë dhe të përmbledhur të gjendjes aktuale të situatës dhe njëkohësisht shërbeu si një bazë mbështetëse e dobishme gjatë diskutimeve dhe analizës së fokus grupeve. Kështu, metodologjia kishte për qëllim të ndërlidhte dhe të kombinonte burimet e ndryshme të informacionit. U aplikua qasja nga lart-poshtë (shqyrtimi i literaturës dhe puna në terren), e kombinuar me qasjen nga poshtë-lart (intervistat dhe diskutimet në fokus grupe). Në këtë drejtim, qëllimi i intervistave dhe i diskutimeve të fokus grupeve ishte të siguronte një profil të plotë për sa i përket zonës gjeografike, karakteristikave të grupit, llojit të martesës dhe distancave në moshë, perspektivës arsimore dhe profesionale, tipet e familjeve dhe numrit të fëmijëve, duke përfshirë një pamje të plotë të tipareve të fenomenit

dhe ekzistencës së politikave të implementuara jo vetëm në Qarkun e Korçës dhe Vlorës por dhe në të gjithë vendin. Të dhënat e mbledhura janë filtruar dhe analizuar në përputhje me objektivat e nismës. Në bazë të këtyre analizave ky studim ka prodhuar gjetje dhe rekomandime.

1. Studimi i përfunduar ishte mjaft i rëndësishëm për analizën e *problematikës së martesave të hershme* dhe propozimet për ndryshimet e nevojshme të politikave. Në zhvillimin e seksionit lidhur me “sasinë (statistikat) e martesave të hershme” të dhënat e mbledhura në nivel lokal ishin të dobishme për të kuptuar situatën në terren për sa i përket martesave të hershme. Të dhënat fillestare në dizpozicion të strukturave të qeverisë vendore, policisë, institucioneve shëndetësore, shkollave, dhe organizatave joqeveritare që punojnë me komunitetet në Korçë dhe Vlorë u eksploruan më tej për të identifikuar përhapjen e martesave të hershme në zonat e zgjedhura. Në përgjithësi, marrja e këtyre të dhënave është e vështirë sepse shumë zyrtarë nuk janë të gatshëm për t’u ndarë këtë informacion. Në këtë situatë, angazhimi i stafit të zyrave lokale të Observatorit, i cili ka një model të shkëlqyer bashkëpunimi me këto institucione, rezultoi të ishte një strategji mjaft efektive në mbledhjen e informacionit. Ne rekomandojmë që në kuadrin e një studimi kombëtar, paralelisht me veprimet e mësipërme, të kryhen intervista me zyrtarë nga agjensitë e identifikuar më lart me synim grumbullimin e informacionit mbi raste të veçanta dhe procedurat respektive të ndjekura për secilin prej tyre. Nëse është e mundur, duhet që të shqyrtohen gjithashtu

të dhënat e gjykatës për raste specifike, proces që nuk u arrit të kryhej gjatë kësaj faze të studimit. Megjithatë, ne mundëm të merrnim informacion nga gjykatat e rretheve përkatëse në lidhje me vendimet e marra për lejimin apo refuzimin e rasteve të martesave të hershme. Studiueset tona, gjithashtu, ndërmorrën një shqyrtim të artikujve mediatikë mbi martesat e hershme të lidhura me këto zona sidomos kur kjo dukuri ka shërbyer si “urë ndërmjetëse” për forma të ndryshme trafikimi apo shfrytëzimi seksual. Këto të dhëna janë krahasuar edhe me të dhënat e prodhuara nga organizata të tjera ndërkombëtare si UNICEF dhe UNFPA.

2. Të dhënat cilësisore në lidhje me martesat e hershme ishin gjithashtu të kufizuara. Burimi ynë kryesor për këto dhëna ishin intervistat individuale (88 gjithsej në Korçë dhe Vlorë) dhe takimet me fokus grupet (dy për secilën komunë). Intervistat u bazuan në aplikimin e pyetësorëve të strukturuar, me pyetje të mbyllura dhe të hapura duke synuar mbledhjen e informacionit si nga vajzat/gratë që sapo janë përfshirë në një martesë të legalizuar, ashtu dhe prej atyre që kanë vite në një marrëdhënie të tillë, të legalizuar ose jo. Duke synuar ndërtimin e një marrëdhënie të besueshme me të intervistuarit, mbrojtjen e identitetit dhe të të drejtave të tyre u tregua një kujdes maksimal për të shmangur diskutimet mbi ndalesat ligjore të martesave të hershme, procedurat për verifikimin e moshës gjatë regjistrimit të martesave etj. Nga ana tjetër, u diskutua në detaje mbi shkaqet, faktorët ndikues të këtyre martesave pa kërkuar informacion të personalizuar.

Disa nga fushat e këtyre diskutimeve dhe analize përfshinë:

- a. faktorët familjarë,
 - b. kulturorë,
 - c. social,
 - d. ekonomik,
 - e. vijimi i shkollimit për vajzat dhe niveli arsimor i prindërve të tyre,
 - f. mohimi i mundësive për arsimim dhe argëtim,
 - g. detyrimi për t'u angazhuar në punët shtëpiake ose në aktivitete të tjera për të gjeneruar të ardhura,
 - h. përgjegjësia për kujdesin ndaj fëmijës në rastet e shtatzënive/lindjes së një fëmije,
 - i. ndikimet shëndetësore veçanërisht të lidhura me abortet e detyruara,
 - j. të qenurit subjekt i dhunës familjare ose abuzimit,
 - k. marxhinalizim dhe diskriminim.
3. Ajo që mësuam në lidhje me tiparet e fenomenit të martesave të hershme lidhet me informacionin e pakët që ekziston në lidhje me këtë grup shoqëror. Një rekomandim që rrjedh nga hendeuku i të dhënave analitike do të ishte mbledhja e të dhënave të detajuara kombëtare për grupmoshën 14- 18 vjeç dhe 19- 25 vjeç, për të analizuar korrelacionin e fenomenit me të dhënat arsimore.
 4. Analiza e argumenteve shqetësues lidhur me martesat e hershme u mbështet kryesisht në punën e kryer në terren. Observatori u mbështet tek stafi i zyrave rajonale në Vlorë dhe Korçë, të cilët u trajnuan rreth procesit

të intervistimit dhe organizimit të fokus grupeve. Kërkesit u trajnuan nëpërmjet një tele-seminari i cili synonte familjarizimin me objektivat kërkimore, zhvillimin e aftësive të tyre për të ndërtuar marrëdhënie besimi me të anketuarit, përdorimin me efektivitet të komunikimit, dëgjimit, empatisë etj. Vëmendje serioze iu kushtua edhe çështjeve etike, duke konsideruar me kujdes trajtimin e nëntemave me ndjeshmëri të lartë për të shmangur kapërcimet në sferën private. Të gjithë pjesëmarrësit u informuan mbi politikën e privatësisë dhe konfidencialitetit duke u siguruar për mbrojtjen e informacionit të dhënë prej tyre dhe të përdorur në kuadrin e këtij projekti duke shmangur identifikimin e tyre apo shfaqur informacione personale të panevojshme. Gjatë aktivitetit, pjesëmarrësit qenë të lirë të shprehnin vullnetin e tyre për kryerjen e fotografive dokumentuese dhe aprovimin përkatës për publikimin e tyre vetëm në kuadër të raportimit për këtë projekt dhe për asnjë qëllim tjetër jashtë këtij studimi. Koordinatorët monitoruan nga afër intervistuesit për të siguruar mbarëvajtjen e procesit, një atmosferë bashkëpunuese dhe vlefshmërinë e informacionit të mbledhur. Në përfundim të punës në terren, ekspertët u mblodhën në Tiranë, në një takim i cili shërbeu për të ndarë dhe analizuar së bashku ngjashmëritë, ndryshimet, sfidat dhe strategjitë e përdorura në dy qarqe të ndryshme të Shqipërisë. Puna e kryer nga ekipi si në procesin e kryerjes dhe regjistrimit të intervistave ashtu dhe gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave nga fokus- grupet dhe informacionit nga aktorët lokalë ishte kryer konform standarteve etike dhe profesionale.

5. Në zhvillimin e një metodologjie kërkimore në nivel kombëtar duhet të mbahet parasysh zgjerimi i grupit të të intervistuarve duke përfshirë familjarë (bashkëshortë, fëmijë), punonjës socialë, mësues, prindërit e vajzave/ grave të martuara herët, dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore. Për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me fenomenin e martesave të hershme është e rëndësishme të përfshihen dhe personalitete të artit apo mediatikë të cilët mund të kenë eksperiencë të martesave të hershme. Impakti i mesazheve të tilla është shumë i madh dhe pozitiv.

D. Identifikimi i Njëanshmërisë Kërkimore

Ky studim nuk kishte për qëllim të mblidhte informacion mbi prevalencën e fenomenit por mbi arsyet dhe pasojat e tij. Kampioni i përzgjedhur dhe numri i intervistave ishte qëllimisht i kufizuar për të na dhënë mundësinë e një analize të zgjeruar cilësore. *Ka njëanshmëri të qartë ndaj grave në martesa të hershme në këtë studim pasi ai përpiqet të nxjerrë informacion lidhur me to, në mënyrë që t'iu bëhet mirë si atyre dhe familjeve që ato kanë krijuar.* Numri i rasteve brenda studimit ishte i kufizuar në mënyrë që të lehtësohej në thellësi secila dukuri. Vlerësimi bëhej sipas një fushe dhe qëllimi shumë të qartë. Fokus grupet dhe pyetësorët ishin në funksion të nismës kërkimore mbi martesat e hershme dhe parandalimin e tyre.

1. Puna e ngritur dhe zbatuar në terren ishte e kufizuar vetëm gjatë kohështirjes së kësaj inisiativë. Një kohëzgjatje më e madhe do të kishte qenë më e

dobishme ndaj dhe duhet marrë në konsideratë për studimin në nivel mbarëkombëtar.

2. Natyra sensitive e temës së trajtuar gjatë këtij studimi kërkonte domosdoshmërisht dhe para së gjithash vendosjen e një marrëdhënieje besimi në të cilën pjesëmarrëset ndihen të mbrojtura dhe të sigurta për të dhënë informacion të qartë, të plotë dhe të dobishëm.
3. Intervistuesit u këshilluan të fillonin intervistat vetëm kur pjesëmarrëset të ishin të gatshme, pa i sforcuar. Atyre ju kërkua të mos vazhdonin me aplikimin e pyetësorit, nëse vërenin shenja stresi, ankthi, sikleti tek pjesëmarrëset. Ata u udhëzuan sesi duhet të vazhdonin nëse vajzat e reja ndiheshin të shqetësuara nga pyetjet.
4. Për shkak të aksesit të kufizuar në të dhëna, dokumentacioni zyrtar që ka të bëjë me martesën e hershme nuk u analizua. Në këtë studim u analizuan vetëm materialet e publikuara dhe në dispozicion të publikut.
5. Studimet e kësaj natyre duhet të kryhen me kujdes dhe etikë të lartë profesionale dhe kjo kërkon kohë. Për më tepër, marrja e informacionit cilësor është e nevojshme për të kuptuar kompleksitetin e problematikave të martesave të hershme dhe për të mos rënë në grackën e përgjithësimeve statistikore.
6. Krijimi i një marrëdhënie të shkëlqyer me pjesëmarrësit është çelësi për të marrë këtë informacion kaq sensitiv. Gjatë dizenjimit të studimeve të ngjashme është e nevojshme të planifikohet kohë e mjaftueshme e cila është shumë e domosdoshme për trajtimin e çështjeve të tilla.
7. Ky dokument bazohet në studimet e rasteve në Korçë

dhe të Vlorë dhe reflekton një proces dinamik ende të papërfunduar, por që me gjetjet e deritanishme ndihmoi në identifikimin e disa mangësive që kanë të bëjnë me martesat e hershme ndërsa vlerësonim situatën në zonat pilot dhe mësonim shumë më tepër për problemet që duhen adresuar në shkallë kombëtare.

8. Kufizimet e pranuar dhe kampioni i vogël i këtij studimi nuk duhet të përbëjnë pengesë që zbulimet e këtij studimi të përdoren për të reflektuar mbi çështjet shqetësuese dhe prioritizimin e tyre. Ata që punojnë për reformën ligjore, atë politike dhe ndërhyrjet strategjike mund t'a përdorin këtë studim për të adresuar problemet e identifikuara duke sjellë eliminimin e fenomenit të martesave të hershme.

IV. Zhvillimi human kundrejt të drejtave të njeriut

Ky vlerësim rreket gjithashtu të lidhë zhvillimin njerëzor me atë të zhvillimit të burimeve njerëzore. Tranzicioni drejt demokracisë dhe ekonomisë së lirë të tregut nuk kaloi pa kosto për shqiptarët. Veçanërisht, kostot njerëzore që pasuan këtë proces ishin të mëdha dhe ndonjëherë të papërballueshme¹⁹. Vajzat/ gratë e përfshira në martesat e hershme, janë njëri nga grupet shoqërore, të ndikuar drejtpërdrejt nga tranzicioni dhe kostoja e paguar prej tyre vërtetë është shumë e rëndë, shpesh një tërheqje absolute nga jeta shoqërore dhe profesionale. Rinia e sotme, grupmosha 15-24 vjeç mund të konsiderohet lehtësisht si një nga produktet e tranzicionit²⁰. Për më tepër, makro zhvillimet socio-ekonomike që ndodhën në Shqipëri, nuk u shoqëruan me zhvillime në nivele mikro, të ngjashme me ndërhyrjet që ne synojmë të aplikojmë. Si rezultat u krijuan shpesh qarqe vicioze rreth fenomenit të martesave

¹⁹ Për një vlerësim të detajuar të tranzicionit dhe migrimit të brendshëm të ndodhur në Shqipëri ju lutem referojuni një studimi të bërë nga Clarissa de Waal in *Albania Today: A Portrait of Post-communist Turbulence*, I.B.Tauris & Co Ltd, 2005

²⁰ Kjo grupmoshë u rrit dhe u zhvillua në kontekstin e një tranzicioni të vazhdueshëm socio-ekonomik, gjatë të cilit ka patur ndryshime të vazhdueshme por asgjë nuk është përcaktuar definitivisht.

të hershme, papunësia u rrit ndërsa mundësitë u reduktuan, pra u krijuan barrierat e shumta për zhvillimin njerëzor dhe ushtrimin e të drejtave të njeriut. Gratë në martesat e hershme përfaqësojnë segmente të grave me mungesë të theksuar të aftësive të kërkuara në tregun aktual të punës krahas mungesës së inisiativës për sipërmarrje individuale. Përshtatja e të mësuarit, trajnimit të grave në përputhje me kërkesat e tregut të punës mbetet një sfidë të cilën shpresojmë t'a trajtojmë përmes propozimeve dhe veprimeve të përbashkëta për të eliminuar fenomenin.

A. Normat dhe legjislacioni për të drejtat e njeriut që trajton martesat e hershme dhe fëmijë në Republikën e Shqipërisë²¹

Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Ajo gjithashtu deklaron se çdo fëmijë ka të drejtën e mbrojtjes nga dhuna dhe shfrytëzimi që mund të dëmtojë shëndetin, zhvillimin normal ose të vënë jetën e tij/saj në rrezik. Legjislacioni shqiptar për fëmijët (Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës) e përkufizon fëmijën si “çdo person i lindur gjallë që është nën moshën 18 vjeçare”²². Ky përkufizim është në përputhje

²¹ Kjo pjesë e studimit bazohet në publikimin Martesa e hershme në Shqipëri: Një vështrim specifik mbi komunitetin rom, të cilin mund t'a gjeni këtu: http://observer.org.al/wp-content/uploads/2015/03/2015-Child_marriage_in_Albania.pdf

²² Shqipëria ratifikoi Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF) më 27 shkurt 1992. Më 25 shtator 2012, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës shqyrtoi raportin e 2, 3 dhe 4 periodik të Shqipërisë. Përfaqësuesit e

me Konventën e OKB për të Drejtat e Fëmijës. Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës gjithashtu përcakton të gjitha të drejtat dhe mbrojtjen e domosdoshme që i nevojitet një fëmije, dhe përcakton mekanizmat dhe institucionet që janë përgjegjëse për garantimin e këtyre të drejtave përkatësisht përmes Këshillit Kombëtar dhe Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të cilat u formuan në vitin 2010. Aprovimi i këtij ligji i hapi rrugën krijimit të njësive për mbrojtjen e fëmijëve në nivel rajonal dhe lokal, si autoritete shtetërore përgjegjëse ku mund të raportohen shkeljet e të drejtave të fëmijëve.

Sipas Kodit të Familjes, mosha minimale ligjore që lejon një shtetas shqiptar të kryejë një martesë është mosha 18 vjeç. Po sipas të njëjtit nen të Kodit të Familjes parashikohen disa raste kur edhe fëmijët nën 18 vjeç mund të lejohen të hyjnë në martesë bazuar në miratimin e gjykatës së rrethit. Disa nga këto raste të cilat merren në konsideratë nga Gjykata lidhen me shtatzëninë apo nevojën për të emigruar me partnerin (ende jo bashkëshortin). **Në raste të tilla bie përcaktimi i moshës minimale.** Sipas të gjitha instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara dhe sipas legjislacionit shqiptar të gjitha martesat duhet të bazohen në pëlqimin e vullnetshëm të dy bashkëshortëve

Shqipërisë prezantuan ligjin e ri mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të miratuar më 4 nëntor 2010 si dhe Planin e Veprimit për Fëmijë 2012-2015, si hapa progresivë drejt përmbushjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Për herë të parë në këtë raportim krijimi i njësive të të drejtave të fëmijëve në nivel lokal dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve u prezantuan dhe në tagrin e tyre për të monitoruar zbatimin e ligjit dhe Planit të Veprimit për fëmijët.

të ardhshëm, dhe duhet të regjistrohet në zyrën e gjendjes civile.

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë thekson se një person arrin kapacitetin e plotë juridik kur ai ose ajo arrin moshën 18 vjeç. Kodi specifikon, se në qoftë se një vajzë martohet para moshës 18 vjeç, ajo automatikisht arrin kapacitetin juridik. Kapaciteti juridik i jep një personi të drejta dhe detyrime të caktuara ligjore; për shembull, për të nënshkruar marrëveshje, të marrë trajtim mjekësor pa pëlqimin e prindërve, dhe për të regjistruar lindjen e fëmijëve. Megjithatë Kodi Penal nuk e kriminalizon martesën e fëmijëve. Është një referencë në Kodin Penal, në nenin 130 ku thuhet se detyrimi me forcë për të filluar ose vazhduar një bashkëjetesë si dhe kërkesa e një të rrituri për të shkuar jashtë territorit të Shtetit Shqiptar me një fëmijë duke e detyruar atë të martohet, dënohet me gjobë ose deri në tre muaj burg. Sipas të njëjtit Kod Penal, në nenin 100, marrëdhënia seksuale me një të mitur nën moshën 14 vjeç është një vepër penale, dhe dënohet nga 7 deri në 15 vjet burg; ndërsa kryerja e marrëdhënieve seksuale të detyruar me një të mitur të moshës 14-18 vjeç, është një vepër penale dhe dënohet nga 5 deri në 15 vjet burgim.

B. Përfaqësues të qeverisë, shoqërisë civile si dhe fëmijë raportojnë në Sesionin e 61 të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (17 Shtator -5 Tetor 2012)

Lidhur me çështjen e martesave të hershme në Shqipëri, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, kishte nxjerrë një listë të çështjeve për të cilat kërkohej informacion shtesë dhe i përditësuar. Ky informacion iu kërkuar përfaqësuesve

shqiptarë të paraqitej me shkrim. Në paragrafin 3 të Pjesës I, Komiteti kërkoi nga shteti që të jepte informacion mbi masat specifike të ndërmarra për të adresuar problemin e martesave të hershme të cilat raportohen si fenomen i zakonshëm në disa komunitete të caktuara. Përgjigja e shtetit në këtë pikë ishte: *Lidhur me problemin e martesave të hershme ne përmendim se Ligji i Familjes, neni 7 siguron martesën si një e drejtë midis një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Vetëm për arsye të një rëndësie të madhe, mundet vetëm gjykata të lejojë martesën para kësaj moshe (18 vjeç). Kjo fushë është e rregulluar tashmë me dispozitat e ligjit të familjes, të cilat nuk i lejojnë martesat në moshë të re.*

Një raportim tjetër vjen nga konsultimet që Koalicioni Mbrojtjes “Së bashku për Kujdesin e Fëmijëve” (BKTF) organizoi me 26 fëmijë, në Durrës, në Tetor të vitit 2011, të cilët ishin zgjedhur si përfaqësues të 14.534 fëmijëve nga Tirana, Vlora, Durrësi, Kuçova, Elbasani dhe Dibra. Konsultimet ishin të formave të ndryshme duke filluar nga bisedimet, intervistat, pyetësorët, seminarët, trajnimet etj nëpërmjet të cilave u arrit të evidentoheshin një sërë problemesh me të cilat ndeshen fëmijët. Njëri prej këtyre shqetësimeve lidhej me çështjen e martesave të hershme si një vendim i cili merret nga prindërit pa marrë parasysh detyrën e tyre.

C. Vëzhgimet dhe rekomandimet përfundimtare të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve

Pas raportimit të aktorëve të ndryshëm në Komisionin e OKB-së për situatën e të drejtave të fëmijës, përse i për-

ket zbatimit dhe shkeljes së këtyre të drejtave, ***martesat e hershme janë kategorizuar si një “Praktikë e dëmshme”*** nga komiteti dhe rekomandimi i komisionit në lidhje me këtë çështje ishte si vijon: “Komiteti, ndërsa vë në dukje se mosha minimale ligjore e martesës është caktuar- 18 vjeç, shpreh shqetësimin për praktikën e vazhdueshme të martesave të hershme dhe atyre të detyruara, veçanërisht në komunitetin Rom”.

D. Vazhdimi i procesit pas vëzhgimeve dhe rekomandimeve të Komitetit

Që prej muajit Tetor 2012, kur Komiteti dorëzoi rekomandimet për Shqipërinë, nuk ka asnjë dokument zyrtar mbi zhvillime specifike. Gjatë kësaj periudhe, Observatori ka kontaktuar shumë institucione shtetërore dhe jo-shtetërore për të verifikuar nëse është ndërmarrë ndonjë hap konkret nga Qeveria Shqiptare ose Shoqëria Civile për të lehtësuar gjendjen e fëmijëve në Shqipëri në lidhje me çështjen e martesave të hershme. Në bazë të informacioneve tona nga tetori 2012, deri shkurt 2015 nuk është ndërmarrë asnjë masë lehtësuese për të studiuar dhe parandaluar këtë fenomen. Mungesa e veprimit në këtë fushë mbetet ende një mundësi për të adresuar çështjen e martesave të hershme, si në formën e paraqitur në këtë dokument dhe për të parë përtej kufijve etnikë siç kemi bërë në fazën e parë të këtij studimi.

1. Është e rëndësishme për ne (dhe partnerët tanë) të kuptojmë se të drejtat e njeriut janë të verbëra përballë ngjyrës së lëkurës, etnisë, gjinisë dhe kombësisë.

Respektimi dhe zbatimi i të drejtave të tilla nuk duhet të kufizohet vetëm në kategoritë e sipërpërmendura, *shpirti i të drejtave të njeriut*, duhet të trajtohet në mënyrë adekuate me ligjet dhe legjislacionin shqiptar dhe të tejçohen në të gjithë shoqërinë. Në këtë drejtim, diskutimi ligjor mbi martesat e hershme është i paplotë nëse nuk është i shoqëruar me një hulumtim aktiv të situatës në terren që do të ndihmojnë gjyqtarët në të ardhmen për të hyrë në një proces më të thellë të arsyetimit ligjor para se të lejojnë martesën në moshë të hershme.

2. Me anë të këtij studimi, ne synojmë të tregojmë se arsyetimi në migrim apo shtatzani nuk janë arsye të mjaftueshme për të lëshuar një certifikatë për martesë në moshë të mitur. Migrimi është një pjesë integrale e jetës dhe kulturës shqiptare që nga viti 1991 dhe si e tillë ajo nuk duhet të konsiderohet më si një rast i veçantë. Në lidhje me këtë çështje është edhe fakti se martesat e hershme për arsye të migrimit shpesh kanë përfunduar në trafikimin njerëzor apo prostitucion. Një autore e shquar ligjore ngre këtë shqetësim në studimin e saj “Diskriminimi gjinor në familje dhe çështjet martesore”²³ duke e trajtuar shqetësimin e saj me mënyrën se si gjyqtarët marrin vendime lidhur me martesat e hershme.
3. Dr. Mandro me të drejtë trajton çështjen e shtatzënisë

²³ For a full discussion of early marriage please refer to: *Diskriminimi Gjinor në Çështjet Familjare dhe Martesore* by Prof. Dr. Arta Mandro (pages 71 – 78). The study can be accessed in this link: <http://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Diskriminimi%20gjinor%20ne%20ceshtjet%20familjare%20A.%20Mandro.pdf>

si arsye parësore për lejimin e martesës së hershme. Ne bashkohemi në shqetësimin e saj se thjeshtimi i situatës zhvillohet në gjykatë, kur vendimet e hershme të martesës janë të bazuara në shtatzani dhe nuk e konsiderojnë zhvillimin e nënës dhe të fëmijës që pritet të lindë. Ka një korrelacion të fortë në studimin tonë ndërmjet shtatzënisë dhe braktisjes së shkollës që do të analizohet më tej. Nuk ishte qëllimi i kësaj nisme për të shqyrtuar vendimet e gjykatave lidhur me martesat e hershme në vend të kësaj ne jemi duke marrë parasysh si një fëmijë vajzë transformohet në grua si rezultat i martesës së hershme. Megjithatë, ne mund të pohojmë se shumica e vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë me dhënien e martesave të hershme janë të lidhura me shtatzëninë. Ne vazhdojmë të marrim në konsideratë këtë nismë si një mjet për të rritur shqetësimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me shtatzënitë e hershme që bartin në vetvete rreziqe të shumta për nënën në moshë të re dhe të foshnjave të lindur rishtazi, referuar studimeve shëndetësore.

4. Shtimi i vendimeve gjyqësore për martesat e hershme është e kufizuar nga mosha e pjekurisë seksuale vendosur 14 vjeç në Shqipëri. Me fjalë të tjera martesa nën moshën 14 vjeçare tregon kryerjen e përdhunimit statutor. Dr. Mandro përshkruan në studimin e saj situatën e ngjajshme në vendet ku fëmijët janë trafikuar për qëllime prostitucioni- një 14 vjeçare e cila ishte joshur në trafikim përmes premtimeve të rreme për një jetë më të mirë jashtë vendit. Një studim në mbarë vendin do të na lejojë të marrim në konsideratë ekzistencën e një korrelacioni ndërmjet martesave të

hershme dhe trafikimit. Në përvojën ndërkombëtare dhe punën shkencore të kryer jashtë Shqipërisë argumentohet për këtë. Nëse ekzistenca e një modeli të tillë është provuar në Shqipëri ne do të dëshironim të rrisim ndërgjegjësimin dhe zhvillim një fushatë kombëtare që do ta bënte Parlamenti shqiptar të marrë në konsideratë ndryshimin e moshës së pjekurisë seksuale nga 14 vjeç në 15 vjeç. Duke marrë këtë hap Shqipëria lëviz më pranë vendeve në të cilat moshë e pjekurisë seksuale është më e lartë se 14 vjeç dhe më afër 16 vjeç.

5. Ne gjithashtu besojmë se zhvillimi njerëzor dhe shoqëror nuk duhet të bëhet duke shkelur të drejtat e njeriut ose imponuar zhvillimin e shoqërisë mbi supet e disa individëve, duke përfshirë ata që kanë hyrë ose janë detyruar të hyjnë në një bashkim të bazuar në martesat e hershme. Ne shpresojmë që kjo nismë dhe politikat e veprimit që ne propozojmë në faqet në vijim do të shërbejnë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të marrë hapat e nevojshëm politike për të adresuar martesat e hershme në mbarë vendin.


V. Analiza e Thelbësoreve

A. Karakteristika demografike të Martesave të hershme në Korçë dhe Vlorë

Janë intervistuar 102 femra në lidhje me nismën e marrë për martesat në moshë të mitur. Në Korçë u intervistuar 52 gra në martesë të lidhur në moshë të mitur. Midis tyre, ka pasur gra që janë martuar pas moshës 18 vjeç, të cilët nuk i kemi konsideruar në këtë analizë. Intervistat e plotësuara në Korçë janë 31 dhe pyetësi u zhvillua në zonat periferike (17 të anketuara) dhe në Pojan (14 të anketuara). Në Vlorë numri i të anketuarve ishte 50. Të gjitha gratë që janë intervistuar janë martuar para moshës tetëmbëdhjetë vjeçare. Modeli është i vendosur në qytetin e Vlorës (25 të anketuara) dhe në dy zonat periferike Xhyerina (15) dhe Bishan (10).

1. **Mosha aktuale e të intervistuarve.** Siç mund të shihet qartë në grafikun e mëposhtme, grupmosha dominuese e grave të martuara në moshë të hershme është mes moshës 26 dhe 35 vjeç që përfaqësojnë mbi 44% të kampionimit. Në Vlorë, kjo grupmoshë përbën gjysmën e të anketuarve, ndërsa në Korçë grupi duket disi më i vjetër, ku rreth 33% e të anketuarve janë

mbi 36 vjeç. Kjo moshë relativisht e re në mesin e femrave të martuara në moshë të hershme tregon qartë se fenomeni i martesave të hershme është në rritje dhe është i lidhur ngushtë me ndryshimet social-ekonomike që Shqipëria i'u nënshtrua në vitin 1991.



Grafikë 2: Mosha aktuale e të anketuarve

Burimi: Anketim nga Observatori, Nëntor- Dhjetor 2015

- 2. Mosha kur janë martuar të anketuarat.** Shumica e të anketuarve nga Korça janë martuar gjatë moshës 16- 17 vjeç. Kjo është grupmosha dominante me përkatesisht 22% dhe 39% ose 19 raste së bashku. Në Vlorë e njëjta grupmoshë dominon, përkatesisht me 40% dhe 50% të rasteve. Shqetësuese është situata në 3 raste në Korçë dhe 2 raste në Vlorë, në të cilën martesa u zhvillua në moshën 13 ose më herët.

Tabelë 1: Mosha kur janë martuar të anketuarit

Mosha kur janë martuar të anketuarat	Vlorë	Korçë
12 - 13 vjeç	2	3
14 vjeç	0	4
15 vjeç	3	5
16 vjeç	20	7
17 vjeç	25	12

Burimi: Anketim nga Observatori, Nëntor- Dhjetor 2015

- 3. Mosha e grave kur kanë sjellë në jetë fëmijën e parë.** Shumica e grave në martesat e hershme janë tashmë nëna. Në Korçë fëmija i parë ka ardhur në jetë kur e ëma ishte 17 apo 18 vjeç (përkatesisht 26% dhe 32%), në 58% të rasteve. Në Vlorë fëmija i parë ka ardhur në jetë kur nëna i përkiste së njëjtës grupmoshë në 84% të rasteve (42% në çdo grup moshe). Në Korçë, në 55% të rasteve martesa është bërë para se fëmija kish lindur, ndërsa në pjesën tjetër martesa ka ardhur për shkak të shtatëzanisë. Në Vlorë martesat para dhe pas lindjes së fëmijës së parë janë të ndarë në mënyrë të barabartë. Në martesat për shkak të shtatëzanisë, rezulton se shtatëzania ka qënë arsye për martesë. Është e rëndësishme të vihet re se ka dy raste në Vlorë që lindja ka ndodhur kur nëna ishte 14 vjeç.

Tabelë 2: Mosha kur të anketuarit kanë sjellë në jetë fëmijën e parë

Mosha kur kanë sjellë në jetë fëmijën e parë	Vlorë	Korçë
14 vjeç	2	0
15 vjeç	1	2
16 vjeç	1	5

17 vjeç	21	8
18 vjeç	21	10
19 vjeç	1	3
20 vjeç		1

Burimi: Anketim nga Observatori, Nëntor- Dhjetor 2015

4. **Statusi aktual i të martuarave në moshë të hershme:** 61% e grave të intervistuar në Korçë janë të martuar, ndërsa pjesa tjetër janë ose të divorcuar ose të ve. 86% e të anketuarve në Vlorë janë të martuar, pjesa tjetër re tyre është e shpërndarë sipas kategorive në tabelën e mëposhtme:


Tabelë 3: Statusi aktual i të anketuarve

Statusi Aktual	Vlorë	Korçë
Të martuara	43 të përgjigjur- 86%	19 të përgjigjur- 61%
Të divorcuara	5 të përgjigjur- 10%	4 të përgjigjur- 13%
Të ve	1 të përgjigjur	1 të përgjigjur
Të pa martuara	1 të përgjigjur	6 të përgjigjur- 16%
Në process divorci		1 të përgjigjur

Burimi: Anketim nga Observatori, Nëntor-Dhjetor 2015

5. **Diferenca në moshë me bashkëshortët.** Në Korçë diferenca e moshës bashkëshortore varion nga 2 deri në 10 vjet. Diferenca në moshë si 3, 4, 5 dhe 7 vjet është respektivisht 10%. Grupet që dominojnë me 26% dhe 16% janë ato me 2 vjet (tetë raste) të diferencës në moshë dhe 10 vjet (5 raste). Ndryshimi i moshës bashkëshortore në Vlorë është i shpërndarë në mënyrë të barabartë dhe varion nga 2 deri në 20 vjet - 10% është diferenca e moshës me 3, 5, 6 dhe 7 vjet. Grupi dominant është ai në të cilin burri është 9 vjet më i vjetër se gruaja me 12% (6 raste).

6. **Mosha e prindërve të të intervistuarve.** Prindërit e grave në martesat e hershme duket se janë mes moshës 40 dhe 59 dhe të shpërndarë njëtrajtësisht. Kjo mund të jetë edhe një tregues se vendimi për martesat e hershme mund të ketë qenë marrë për shkak të kufizimeve financiare dhe ekonomike. Figura e mëposhtme e bën të qartë se prindërit e të intervistuarve në Korçë janë më të vjetër në krahasim me prindërit e të intervistuarve në Vlorë. Grupi i prindërve, të moshës 70 vjeçare- 79, përfaqëson grupin dominues në Korçë, në krahasim me situatën në Vlorë, ku grupet dominuese janë ato të prindërve mes 40- 59 vjeç.



Grafikë 3: Mosha e prindërve të të anketuarve
Burimi: Anketim nga Observatori, Nëntor- Dhjetor 2015

B. Karakteristika të prejardhjes familjare të grave të martuara në moshë të hershme

1. **Lloji i familjeve.** Situata e të intervistuarve tregon se kryesisht janë të rritura në familje me dy prindër me mbi 70% të rasteve. Në Korçë vetëm 6% e të anketuarve vijnë nga familje me një prind, ndërsa në

Vlorë rastet me një prind përfaqësojnë 16%. Pjesa tjetër e grave janë rritur në familje të cilat kanë përjetuar divorcin apo ato në të cilat prindërit janë rimartuar. Në Korçë kjo situatë prindërore përfaqëson 19% të grupit, ndërsa në Vlorë 6%. Ajo që bëhet mjaft e qartë këtu është fakti se sfondi familjar i të anketuarve është relativisht e qëndrueshme.

Tabelë 4: Lloji i familjeve i të anketuarve

Lloji i familjeve	Vlorë	Korçë
Të dy prindërit	36 të përgjigjur - 72%	22 të përgjigjur- 71%
Një prind	8 të përgjigjur	2 të përgjigjur
Prindër të ndarë	3 të përgjigjur	5 të përgjigjur
Prindër të rimartuar	3 të përgjigjur	1 të përgjigjur
Jetim		1 të përgjigjur

Burimi: Anketim nga Observatori, Nëntor- Dhjetor 2015

- Numri i vëllezërve/motrave.** Në Korçë shumica e grave vijnë nga familje me katër deri në gjashtë fëmijë në rreth 55% të rasteve, ndërsa në Vlorë kjo shumicë korrespondon me gratë që vijnë nga familje me pesë deri në tetë fëmijë në 52% të rasteve.
- Rradha e lindjes së fëmijëve.** Martesat e hershme në Korçë janë karakteristike për fëmijën e dytë ose të tretë në familje, sipas studimit tonë. Kjo situatë ndodh në 61% të rasteve. Në Vlorë, nga ana tjetër, janë karakteristike më shumë në fëmijën katërt apo të pestë në 46 të rasteve.

Tabelë 5: Rradha e lindjes së fëmijëve i të anketuarve

Rradha e lindjes së fëmijëve	Vlorë	Korçë
Fëmija i parë	9	5
Fëmija i dytë	7	11
Fëmija i tretë	11	8
Fëmija i katër dhe i rradhës	23 (rradha e 4 dhe 5 janë dominante)	4 (rradha e 7 dhe 8 janë dominante)
Fëmija i fundit	0	3

Burimi: Anketim nga Observatori, Nëntor- Dhjetor 2015

- Statusi i punësimit të prindërve.** Tabela e mëposhtme tregon se shumica e prindërve të të intervistuarave janë të papunë. Edhe pse studimi është i qartë të dhënat duhet të jenë të verifikuara me të dhënat statistikore të mirëqenies. Papunësia në mostrën e anketës në nivel mbi 60% është shqetësues dhe siç do të shohim më poshtë është reflektuar edhe në statusin e punësimit të grave të cilat janë martuar herët.

Tabelë 6: Punësimi i prindërve të të anketuarve

A punojnë prindërit tuaj:	Vlorë		Korçë	
Po	Të punësuar = 20	40%	Të punësuar = 8	32%
Jo	Të papunësuar = 30	60%	Të papunësuar = 21	68%


Burimi: Anketim nga Observatori, Nëntor- Dhjetor 2015

- Migrimi i prindërve** nuk duket të jetë një faktor i rëndësishëm në lidhje me martesat e hershme. Në Korçë 8 nga pjesëmarrëset e studimit kanë pasur

prindër të cilët emigruar, ndërsa në Vlorë vetëm 13 pjesëmarrës kanë prindërit migratore. Vendet që janë paraqitur për migrimin janë Greqia (13 raste) dhe Italia (5 raste).

C. Karakteristika arsimore të grave të martuara në moshë të hershme

1. **Niveli i Arsimit.** Gratë me nivel të ulët arsimor dominojnë grupin e të anketuarve në të dy bashkitë, përkatësisht me 74% në Korçë dhe 82% në Vlorë. Ky konstatim përkon me të dhënat ndërkombëtare ku është identifikuar korrelacioni midis nivelit të ulët të arsimit dhe martesat e hershme.




Grafikë 4: Niveli arsimor i të anketuarve

Burimi: Anketim nga Observatori, Nëntor- Dhjetor 2015

Krahasimi i nivelit arsimor të prindërve me atë të intervistuarave tregon një korrelacion domethënës. Të


intervistuarat kanë një rritje shumë të vogël të numrit të viteve të kaluara në shkollë në krahasim me prindërit. Është mjaft e qartë se niveli arsimor i të intervistuarave përputhet me atë të prindërve të tyre. Për ta bërë këtë krahasim më të saktë për proceset politikëbërëse, anketa duhet të përmbajë pyetje lidhur me arsimimin për nënat dhe baballarët veç e veç për të kuptuar më mirë reciprocitetin në këtë lidhje.



Grafikë 5: Arsimiti i grave të martuara në moshë të hershme me arsimimin e vet prindërve

Burimi: Anketim nga Observatori, Nëntor- Dhjetor 2015

